



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 maj 2022
Nr.ref.:AGJ1988/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI133/20

Parashtrues

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së pikës së dytë të dispozitivit të
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 12/2020
të 19 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Vjosa Kika, konsulente ligjore në Kika & Associates SHPK në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme). Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 8 qershor 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së pikës së dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës, më 7 mars 2022, ka parashtruar kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ca. nr. 1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë në procedurë kontestimore. Procedura e zhvilluar kontestimore, i referohet pikës së parë të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, i cili nuk është objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë së kërkesës së parashtruesit të kërkesës, të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Masat e Përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 17 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 24 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 5 tetor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të plotësojë formularin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe po ashtu i dërgoi

Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

9. Më 19 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës në Gjykatë.
10. Më 3 nëntor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi fletëkthesën e kërkuar, e cila dëshmon që parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 8 qershor 2020.
11. Më 27 prill 2021, përfaqësuesja ligjore e parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë *“parashtresë për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.Nr.12/2020 i dates 19 shkurt 2020”*. Parashtresën e saj, përfaqësuesja ligjore e kishte mbështetur në rregullin 34 [Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, nxori Vendimin KSH.KI133/20 për caktimin e gjyqtarit Safet Hoxha si anëtar në Kolegjin shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
15. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KK160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.
16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
17. Më 7 tetor 2021, Gjykata, përkritazi me kërkesën e tanishme, respektivisht KI133/20 dhe kërkesën KI78/21 i dërgoi Gjykatës Supreme kërkesën për

përgjigje në pyetjet: (i) Për aq sa është e mundur, luteni që ta njoftoni Gjykatën përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, të KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] dhe (ii) Luteni që të na sqaroni se cila është praktika relevante gjyqësore përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK-ut, të vitit 1989 dhe dispozitave të Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës përmes Njoftimit të Punëdhënësit, si rezultat i konstatimit të shkeljeve të detyrave të punës nga punëmarrësit. Më konkretisht, luteni të na sqaroni se a ka Gjykata Supreme një praktikë gjyqësore të unifikuar në këso raste apo çështja e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, i KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] shqyrtohet nga rasti në rast. Nëse Gjykata Supreme ka një praktikë të unifikuar dhe konsistente në lidhje me çështjet e sipërcekura, luteni që po ashtu të na sqaroni se nga cila periudhë saktësisht ka filluar unifikimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.

18. Më 10 tetor 2021, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë shkresën me përgjigjet ndaj pyetjeve të lartcekura të Gjykatës.
19. Më 22 shkurt 2022, Gjykata njoftoi F.S. [palë paditëse në procedurën kontestimore, e cila është objekt i vlerësimit të kërkesës] përkitazi me regjistrimin e kërkesës.
20. Më 7 mars 2022, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë parashtrroi kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ca. nr. 1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë në procedurë kontestimore. Procedura e zhvilluar kontestimore, i referohet pikës së parë të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme.
21. Më 30 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi: (i) që të shpallë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) konstatoi se pika e dytë e Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

22. Sipas shkresave të lëndës, në vitin 2003, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e punëdhënësit dhe F.S., në cilësinë e punëmarrëses kishin lidhur kontratë të punës për një periudhë të pacaktuar kohore. Në bazë të kontratës së punës, F.S. ishte punësuar si zëvendës menaxhere e degës së parashtruesit të kërkesës në Prizren.
23. Më 12 prill 2008, parashtruesi i kërkesës përmes Njoftimit e kishte suspenduar F.S. nga puna, nën dyshimin se e njëjta ka kryer transaksione financiare të paautorizuara. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës në pajtim me rregullat

dhe procedurat e brendshme të tij kishte iniciuar një hetim përmes procedurës së auditimit të brendshëm.

24. Më 14 prill 2008, auditorët e brendshëm në raportin e tyre të auditimit kishin konstatuar diferencën në thesarin e degës në vlerë prej EUR 87.000,00, si rezultat i transaksioneve të kryera nën përgjegjësinë e F.S.
25. Më 15 prill 2008, F.S. kundër Njoftimit për suspendim, të 12 prillit 2008, kishte parashtruar ankesë, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe kthimin e saj në vendin e punës.
26. Më 21 prill 2008, parashtruesi i kërkesës nxori Njoftimin për shkëputje me efekt të menjëhershëm të kontratës së punës së F.S. (në tekstin e mëtejshëm: Njoftimi, i 21 prillit 2008).
27. Njoftimin e tij për shkëputje të kontratës së punës, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, e kishte arsyetuar se F.S. kishte lejuar punëtorët të kryejnë transaksione të paautorizuara, duke i dhënë një klienti të tij *“shuma të parave nga thesari i parashtruesit të kërkesës, pa i regjistruar të njëjtat në sistemin e brendshëm të pagesave”*.
28. Më 29 maj 2008, F.S. kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prizren, përmes së cilës kishte kërkuar anulimin e Njoftimit të 21 prillit 2008 dhe kishte kërkuar kthimin në vendin e saj të mëparshëm të punës.
29. Më 29 korrik 2008, Prokuroria e Qarkut në Prizren kishte ngritur aktakuzë [PP.nr.160/2008] ndaj F.S. dhe dy personave të tjerë nën dyshimin e bazuar për kryerjen e veprës penale të *“shpërdorimit të pozitës zyrtare ose i autorizimit”* të cilën në një datë të paspecifikuar e kishte ndryshuar me veprën penale *“përdorim i paautorizuar i pasurisë”*.
30. Më 10 nëntor 2008, Gjykata Komunale në Prizren, si rezultat i fillimit të procedurës penale kundër F.S. ndërpreu procedurën kontestimore përkitazi me kërkesëpadinë e F.S. të parashtruar më 29 maj 2008.

Procedura penale ndaj F.S.

31. Më 31 korrik 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren përmes Aktgjykimit [P.nr. 222/2008] e liroi F.S. nga akuza në lidhje me veprën penale të *“përdorimit të paautorizuar të pasurisë”*.
32. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, Prokurori Publik i Qarkut në Prizren kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme.
33. Më 24 prill 2011, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Ap.nr. 332/2009] aprovoi ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren dhe anuloi Aktgjykimin [P.nr. 222/2008] e 31 korrikut 2009, të Gjykatës së Qarkut duke e kthyer lëndën në rivendosje.

34. Më 25 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të rënda në procedurë të rivendosjes, përmes Aktgjykimin [Pnr. 203/2013] e liroi F.S. nga akuza. Në konstatimin e dhënë në këtë Aktgjykim, Gjykata e Qarkut theksoi se: *"[...] veprimet e të akuzuarve nuk kane patur për qëllim ti bëjnë dëm bankës në aspektin financiar, por përkundrazi me veprimet e veta kanë shkaktuar fitime për bankën"*.
35. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
36. Më 12 mars 2014, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 41/14] aprovoi ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ndryshoi Aktgjykimin [P.nr. 203/2013] e 25 nëntorit 2013, të Gjykatës Themelore dhe F.S. e shpalli fajtorë për veprën penale *"përdorim i paautorizuar i pasurisë"* duke i shqiptuar F.S. dënim me gjobë.
37. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, F.S. kishte parashtruar ankesë.
38. Më 6 maj 2014, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [PA.II.nr.2/2014] konstatoi se vepra penale për të cilën F.S. akuzohej kishte arritur parashkrimin absolut dhe për pasojë e refuzoi akuzën e ngritur ndaj saj.

Procedura kontestimore përkitazi me Njoftimin e 21 prillit 2008 për shkëputjen e kontratës së punës

39. Më 21 shtator 2015, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) në kuadër të procedurës kontestimore, të iniciuar sipas kërkesëpadisë së F.S. të 29 majit 2008, përmes Aktgjykimit [C.nr. 593/14]:
 - I. Aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e F.S.;
 - II. Anuloi si të kundërligjshëm Njoftimin e 21 prillit 2008, të parashtruesit të kërkesës për shkëputjen e kontratës së punës;
 - III. Detyroi parashtruesin e kërkesës që F.S. ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, duke i kompensuar edhe pagat për periudhën 21 prill 2008 deri më 21 qershor 2015 në shumë prej 111,916.89 euro; dhe
 - IV. Detyroi parashtruesin e kërkesës që F.S. t'ia paguajë shpenzimet procedurale.
40. Gjykata Themelore, fillimisht përkitazi me procedurën e administrimit të provave të zhvilluar nga ana e saj, ndër të tjerash i referohet përmbajtjes së Njoftimit, të 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës dhe dëshmisë së auditorëve të brendshëm. Përkitazi me përmbajtjen e Njoftimit, të 21 prillit 2008, Gjykata Themelore duke cituar një pjesë të Njoftimit, ku theksohet: *"Pasi që gjatë muajit janar 2008 në kundërshtim me rregullat dhe detyrat e punës ka lejuar punëtorët me përgjegjësi të plotë që të bëjnë transaksione të paautorizuara"* konstatoi se *"një formulim i tillë dhe konstatim i tillë në këtë njoftim është përgjithësuar nga fakti se pala e paditur [parashtruesi i kërkesës] që e ka marrë këtë njoftim me asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt se këtu paditësi [F.S.] nga*

janari i vitit 2008 ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe ka vepruar në kundërshtim me shkeljet dhe detyrat e punës për këtë periudhë kohore prej katër muajsh, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm për supozimin e veprimeve të kundërligjshme të kryera vetëm për rastin [...] lidhur me transaksionin e bartjes së të hollave në muajin prill të këtij vitit 2008. Pra njoftimi kontestues vërtet është i pakuptimtë dhe njëherit i njëjti nuk ka formën e aktit administrativ”. Në vijim, përkitazi me dëshmitë e auditorëve të brendshëm, Gjykata Themelore iu referua dëshmisë së parë të auditorit të brendshëm A.K. të dhënë në shqyrtimin kryesor në Gjykatën Themelore, ku në Aktgjykimin e saj theksohet se ky i fundit: “...ngelë pranë raportit të auditimit të përpiluar së bashku me eprorin e tij [...] duke theksuar se shuma e dhënë e të hollave prej 87,000.00 euro në emër të klientit [...] ka qenë të holla të thesarit të bankës Raiffeisen. Gjithashtu, ka sqaruar faktin se klientit të cilit i janë dhënë këto të holla është paraqitur tek [parashtruesi i kërkesës] dhe i njëjti ka deponuar shumën e të hollave prej 130,000. 00 në franga zvicerane dhe me këto veprime banka Raiffesien ishte barazuar dhe e njëjta nuk kishte humbje”. Në vijim, Gjykata Themelore po ashtu i referohet dëshmisë së udhëheqësit të Departamentit të auditimit të brendshëm të parashtruesit të kërkesës A.B., dhe në Aktgjykim theksohet se ky i fundit qëndron prapa raportit të tij të auditimit, përmes së cilit është konstatuar se: “[...] në kasafortën e bankës kanë munguar shuma e të hollave 87.000 euro dhe se mungesa e kësaj shume-transaksioni i kryer nuk është arsyetuar me asnjë provë. [...] përgjegjës për këto kanë qenë [S.P, F.S dhe S.R]. i njëjti ka sqaruar se nuk është në dijeni se çfarë masa disiplinore i janë shqiptuar të njëjtëve po ashtu nuk është në dijeni se a është marr në përgjegjësi menaxheri kryesor i degës Raiffeisen Bank në Prizren”.

41. Gjykata Themelore, para se të ofrojë arsyetimin e saj përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë, fillimisht konstatoi se: “Me nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, parashihet se ligji në fuqi në Kosovë përfshinë (a) rregulloret e shpallura nga PSSP-ja dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) legjislacioni në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.” Në vijim të kësaj, Gjykata Themelore konstatoi se “Duke pasur parasysht kohën e ndërprerjes së kontratës së punës dhe paraqitjen e padisë, gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore, si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë edhe Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës (gazeta zyrtare e KSAK nr. 12 viti 1989)”.
42. Si rrjedhojë e kësaj, Gjykata Themelore iu referua dispozitave relevante të Ligjit për Marrëdhënien e Punës, publikuar në Gazetën Zyrtare të KSAK, nr. 12/89, të vitit 1989 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Marrëdhënien e Punës nr. 12/89), të cilat rregullojnë çështjen e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përkatësisht neneve 111, 112 dhe 113 të këtij ligji. Bazuar në këtë, Gjykata Themelore duke iu referuar edhe nenit 2, paragrafit 2 të LPK-së, konstatoi se: “Gjykata zbaton rregullat e së drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.
43. Në vijim, Gjykata Themelore konstatoi se ndërprerja e kontratës së punës, përmes Njoftimit, të 21 prillit 2008, është bërë duke aplikuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji Themelor i Punës) dhe doracakut të Linjës së Veprimit të personelit të parashtruesit të kërkesës. Në këtë sfond, Gjykata Themelore vlerësoi se Ligji Themelor i Punës nuk përcakton: “...në mënyrë të precizuar dhe të detajuar

shkëputjen e marrëdhënies së punës, sikurse parashihet në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës [...] ku parashihen në mënyrë të detajuar rastet e përgjegjësisë së punëtorit në rastet e caktuara, andaj edhe për këtë arsye ka zbatuar ligjin në fjalë [Ligjin për Marrëdhëniet e Punës]”.

44. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata Themelore vërtetoi gjendjen faktike duke theksuar se nuk është kontestuese se F.S. ka qenë në marrëdhënie të punës të parashtruesi i kërkesës, të cilës përmes Njoftimit, të 21 prillit 2008, i është shkëputur kontrata nga ana e parashtruesit të kërkesës; dhe se ndaj F.S. është ngritur aktakuza nën dyshimin e veprës penale, e cila procedurë ka përfunduar përmes Aktgjykimit PA. NR. II 2/2014 të 6 majit 2014 të Gjykatës Supreme, dhe po ashtu nuk është kontestuese se F.S. ka *“qenë në dijeni se klienti [...] ka marrë shumë në të hollave prej 87.000, 00 euro nga Banka Raiffeisen, për të cilën shumë nga ana e klientit ishte deponuar shuma prej 130.000 franga zvicerane, dhe [parashtruesi i kërkesës] nuk kishte pësuar asnjë dëm dhe gjendja në trezor ishte barazuar, pra ishte bërë vetëm konvertimi i të hollave nga franga Zvicerane në euro”*. Sipas Gjykatës Themelore: *“Kontestuese për palët ndërgjygjëse ishte çështja e ligjshmërisë së njoftimit (vendimit) të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës të paditësit, pra çështja se e paditura këtë vendim a e ka marrë në përputhje me dispozita ligjore të parapara e të cilat kanë qenë në fuqi në atë kohë si dhe ky njoftim a është bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike”*.
45. Bazuar në dispozita e lartcekura të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK, të vitit 1989, Gjykata Themelore, pas administrimit të të gjitha provave përkatëse vlerësoi se parashtruesi i kërkesës Njoftimin, e 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës e ka nxjerrë pa zbatuar procedurën disiplinore sipas procedurave të parapara ligjore për shkeljen e detyrave të punës dhe për pasojë shqiptimi i masës disiplinore është bërë pa u formuar një komision disiplinor. Rrjedhimisht, dhe bazuar në atë si më lart, Gjykata Themelore konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës është i paligjshëm.
46. Së dyti, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi i kërkesës me rastin e nxjerrjes së Njoftimit, të 21 prillit 2008, është: *“...dashur të zbatojë dispozitat e ligjit mbi punën e bashkuar e që është i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24”*. Bazuar në këtë konstatim, Gjykata Themelore duke iu referuar nenit 219 të Ligjit të Punës së Bashkuar konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, i marrë nga parashtruesi i kërkesës: (i) nuk përmban arsyet e marrjes së një vendimi të tillë; dhe po ashtu (ii) nuk përmban këshillën juridike përkitazi me të drejtën e kundërshtimit të vendimit, në rast se pala është e pakënaqur me vendimin.
47. Së treti, Gjykata Themelore pas konstatimit të saj se Njoftimi, i 21 prillit 2008, është i paligjshëm, në pajtim me nenin 73 të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK, të vitit 1989, F.S. i njohu edhe të drejtën për kompensim të pagave të parrealizuara, kompensimin në emër të kontributit pensional dhe tatimit në pagë. Lartësinë e kompensimit, Gjykata Themelore e bazoi në ekspertizën financiare të dhënë nga eksperti i caktuar nga kjo gjykatë.
48. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

49. Më 18 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.484/2016]:
- I. Refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me: (i) Njoftimin, e 21 prillit 2008; dhe (ii) detyrimin për kthim të F.S. në vendin e saj të mëparshëm të punës, dhe në lidhje me këtë vërtetoi Aktgjykimin [C. Nr. 593/2-14] e 21 shtatorit 2015, të Gjykatës Themelore.
 - II. Pjesërisht aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me: (i) kompensimin e pagave ndaj F.S. për periudhën 21 prill 2008 deri më 21 qershor 2015; (ii) dhe shpenzimet procedurale; dhe në lidhje me këtë prishi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore duke e kthyer lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje.
50. Gjykata e Apelit përkitazi me pikën I. përmes Aktgjykimit të saj vërtetoi konstatimin e Gjykatës Themelore se Njoftimi, i 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës është bërë në mungesë të Komisionit disiplinor dhe se ky i fundit nuk përmban elementet e një vendimit të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK, nr. 12/89.
51. Ndërsa përkitazi me pikën II. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore për aprovimin e kërkesëpadisë së F.S. për: (i) kompensimin e pagave ndaj F.S. për periudhën 21 prill 2008 deri më 21 qershor 2015; dhe (ii) shpenzimet procedurale është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore, respektivisht pikës n), paragrafit 2 të nenit 182 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm :LPK). Konstatimin e saj në lidhje me këtë të fundit, Gjykata e Apelit e arsyetoi se: *"Dispozitivi i Aktgjykimit [të Gjykatës Themelore] është në kundërshtim me arsyet e dhëna, respektivisht gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsye bindëse se si ka ardhur në përfundimin që [F.S] për periudhën që do ti kompensohen të ardhurat personale për shumën e gjykuar"*.
52. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave procedurale.
53. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën për revizion, në mënyrë specifike e kontestoi konstatimin e Gjykatës se Apelit: se (i) njoftimi mbi shkëputjen e kontratës së punës është bërë në mungesë të Komisionit disiplinor; dhe se (ii) Njoftimi mbi shkëputjen e kontratës së punës nuk i ka elementet e një vendimi të ligjshëm. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, konstatimet e Gjykatës së Apelit i konsideroi si të paqëndrueshme, për arsye se sipas tij shkëputja e kontratës së punës, përmes Njoftimit, të 21 prillit 2008, është realizuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27].
54. Përkitazi me pretendimin për aplikim të gabuar të ligjit nga Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore, parashtruesi i kërkesës specifikon se shkëputja e kontratës është realizuar në bazë të nenit 11 të Ligjit Themelor të Punës, dhe në këtë aspekt specifikon se në bazë të pikës c, paragrafit 1 të nenit 11 të këtij Ligji: *"Kontrata e Punës mund të shkëputet [...] në rastet e renda të sjelljes së keqe nga punonjësit"*,

si dhe paragrafi 3, pika (b) *"Raste të rënda të shkeljes së keqe paraqesin [...] shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit"*.

55. Në vijim, parashtruesi i kërkesës nënvizoi se në rastin konkret Ligji Themelor i Punës [Rregullore e UNMIK-ut 2001/27] nuk përcakton obligimin për zhvillimin e procedurës përmes Komisionit disiplinor. Ndërsa përkitazi me konstatimin se Njoftimi, i 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës nuk i ka elementet e një vendimi të ligjshëm, për arsye se ndër të tjera nuk përmban arsyetimin edhe këshillën ligjore, parashtruesi i kërkesës specifikoi se: *"[...] në Njoftimin për Shkëputjen e Kontratës së Punës në arsyetimin e të njëjtës në mënyrë decitive janë përshkruar shkeljet e kryera nga ana e [F.S.], dhe baza ligjore për shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe ndaj të njëjtit [F..S] ka ushtruar ankesë, dhe çdo veprim i [parashtruesit të kërkesës] ka qenë në harmoni të plotë me dispozitat e LTHPK [Ligjit Themelor të Punës] duke pasqyruar se një njoftim i tillë është lëshuar nga Drejtori Gjeneral i [parashtruesit të kërkesës] në cilësi të autoritetit suprem pranë [parashtruesit të kërkesës]"*.
56. Në fund, parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij iu referua edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme duke theksuar se: *"[...] kishte hasur në një mori të Aktgjykimeve të gjykuara pothuajse nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës që për raste identike kishte vendosur ashtu siç është kërkuar nga [parashtruesi i kërkesës] në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë po ashtu siç është propozuar në këtë revizion, duke mos e marrë për bazë komisionin disiplinor për faktin se me rastin e vërtetimit të shkeljeve të rënda përshtatshmërisht duhet të zbatohet LTHPK [Ligji Themelor i Punës]"*.
57. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020]:
- I. Pranoi pjesërisht si të bazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës sa i përket detyrimit për parashtruesin e kërkesës që F.S. ta kthejë në vendin e saj të mëparshëm të punës, dhe për pasojë prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe lëndën e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore; dhe
 - II. Refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me anulimin si të kundërligjshëm të Njoftimit, të 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës.
58. Përkitazi me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme gjatë vlerësimit të saj nëse Njoftimi, i 21 prillit 2008, ishte i bazuar në ligj, fillimisht iu referua dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë ligjin e aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret. Në këtë aspekt, Gjykata specifikoi se: *"Dispozitat e Ligjit mbi marrëdhënien e punës i KSAK nr.12/89 ishte i zbatueshëm sipas UNMIK/REG/1999/24 deri me aprovimin e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rreg. UNMIK2001/27, përveç atyre që janë në kundërshtim me këtë Rregullore. Ky ligj ka qenë në fuqi deri në shfuqizimin e tij sipas nenit 27 të Rreg. UNMIK 2001/27 dhe me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212"*. Për pasojë, Gjykata Supreme konstatoi si të drejtë qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se në bazë të nenit 111, paragrafit 2 të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK-ut nr. 12/89 i punësuar i përgjigjet *"vetëm për shkeljet që kanë qenë të normuara me ligj ose akt të brendshëm"*.

59. Së dyti, Gjykata Supreme vlerësoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, nuk: *“...përmban elemente të parapara me ligj si udhëzimi apo këshilla juridike, nuk respekton kohën e paraparë për dëgjim të palës dhe shkelja e pretenduar e punëtorit nuk i përgjigjet sanksionit disiplinor”*. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, është i paligjshëm dhe vërtetoi konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se kundër F.S. nuk ishte zhvilluar procedurë disiplinore për të vërtetuar: *“...përgjegjësinë e saj dhe nuk ishte shqiptuar masa adekuate me shkeljen e paraparë me aktin e brendshëm”*.
60. Ndërsa, sa i përket pikës I të dispozitivit të Aktgjykimit, Gjykata Supreme arsyetoi se në këtë pikë Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit ishin përfshirë në shkelje thelbësore të nenit 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së për shkak se: *“...përfshihen me paqartësi dhe të meta në dispozitivin dhe arsyetimin e tyre përkitazi me disa fakte të konsideruara si relevante për të garantuar një gjykim të drejtë”*. Në kontekst të këtij konstatimi, Gjykata Supreme specifikoi si në vijim: *“Në këtë drejtim mungojnë arsyet për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me atë se a është pozita e zëvendëmenaxherit si vend pune me autorizime të posaçme dhe se a është duke i kryer këto detyra të punës në këtë vend të punës dikush tjetër, fakt ky që është mjaft i rëndësishëm duke pasur parasysh se që nga largim i [F.S.] nga ky vend pune e deri më tani kanë kaluar mbi 10 vite dhe për këtë arsye me pritshmëri të madhe mund të besohet se [parashtruesi i kërkesës] dikë tjetër e ka sistemuar në atë vend pune dhe tani vie në pyetje siguria juridike e dikuj tjetër si person i tretë i pa përfshirë në këtë proces, kështu që mungesa e dhënies, tani për tani edhe të një alternative tjetër të kthimit të [F.S.] në marrëdhënie pune tek [parashtruesi i kërkesës] dhe detyrimin [e parashtruesit të kërkesës] që [F.S.] ta kthejnë në vendin e punës si zëvendës menaxhere të bankës, këto aktgjykime i bën të paekezkutueshme dhe të pakuptueshme nga mungesa e arsyetimit në këtë drejtim”*.
61. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konkludoi se në procedurë të rigjyimit, Gjykata Themelore duhet të eliminojë paqartësitë në këtë aspekt dhe të konstatojë: (i) nëse pozita e zëvendës menaxheres përfshin përgjegjësi të posaçme; (ii) si realizohet zgjedhja në këtë pozitë të punës; dhe (iii) se a është plotësuar ky vend i punës nga parashtruesi i kërkesës dhe a ekziston alternativa e kthimit në të njëjtin vend të punës apo në një pozitë të ngjashme.

Procedura kontestimore përkitazi me pikën e parë të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme

62. Gjykata fillimisht vë në pah se procedura e reflektuar si më poshtë nuk ndërlihet apo i referohet objektit të vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, të dorëzuar në Gjykatë më 17 shtator 2020. Dokumentacionin apo shkresat që ndërlihen me procedurën e reflektuar si më poshtë, parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar më 7 mars 2022.
63. Si rezultat i pikës së parë të Aktgjykimit Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme për kthimin e çështjes në rigjykim në Gjykatën Themelore, kjo e fundit më 9 dhjetor 2020 përmes Aktgjykimit [C. nr. 932/2020] vendosi që:

I. Të aprovojë kërkesëpadinë e [F.S.] si të bazuar;

II. Të detyrojë parashtruesin e kërkesës që F.S.: *“t’ia kompensoj pagat për periudhën që nuk ka punuar nga data 21.04.2008 e deri më 30.09.2020, datën e paraqitjes së ekspertizës në shumat si në vijim: diferencat në neto paga shumën prej 156,861.00 € kurse në emër të kamatës sipas mjeteve të afatizuara për 1 vit pa destinim të caktuar (për diferencë të pagës) prej momentit të ngritjes së padisë e deri në përpilimin e ekspertizës datë 30.09.2020 në shumë prej 18,521.00 € dhe gjithsej në shumën e përgjithshme prej 175,382.00 € në emër të kontributit pensional në paga të papaguara në shumën prej 17,598.00€ si dhe në emër të tatimit në fitim të pagave në shumën prej 13,758.00 € të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.”;*

III. Të detyrojë parashtruesin e kërkesës që F.S. ta kthejë në vendin e saj të mëparshëm të punës; dhe IV. Të detyrojë parashtruesin e kërkesës që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 4,700.00€.

64. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
65. Më 10 janar 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ca. nr. 1578/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 932/2020], të 19 shkurtit 2021 të Gjykatës Themelore.
66. Më 24 shkurt 2022, Gjykata Themelore në Prizren, Dega e Ekzekutimeve nxori Urdhrin Përmbarimor [343/22] përmes së cilit: (i) lejoi propozimin e F.S. për përmbarim të Aktgjykimit [C.nr.932/2020] të 9 dhjetorit 2020, i plotfuqishëm më 10 janar 2022, dhe i ekzekutueshëm nga 23 shkurti 2022; (ii) detyroi parashtruesin e kërkesës që F.S. t’ia kompensojë: *“...shumën prej 175,382.00 € me kamatëvonesë prej 8% nga momenti i lejimit të urdhërit deri në pagesën definitive, në emër të kontributit personal shumën prej 18,521.00€; në emër të tatimit në fitim shumën prej 13,758.00€ [...]”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

67. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [Rev.nr.12/2020], i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme, gëgjësisht pika II e dispozitivit të tij, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
68. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të: (i) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme.
69. Së dyti, në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës specifikon se është shkelur e drejta e tij për trajtim të barabartë si rezultat i dallimeve diskriminuese në trajtimin e *“rasteve tërësisht të njëjta”*.

I.Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Mungesa e vendimit të arsyetuar gjyqësor

70. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj të kontestuar nuk ka dhënë: “...arsyetim të mjaftueshëm dhe të qartë në lidhje me refuzimin e kërkesës së [tij] për të aplikuar dispozitat e Ligjit Themelor të Punës, Rregullorja e UNMIK 2001/27 [tutje referuar si “Ligji Themelor i Punës”], si ligj i aplikueshëm në rastin konkret, qëndrim të cilin Gjykata Supreme deri në momentin e nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar e [ka] zbatuar në mënyrë konsistente në praktiken e saj. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e kontestuar fillimisht përcakton se cili është ligji i aplikueshëm, dhe në kundërshtim me përcaktimin e vet dhe pa dhënë arsyetim të qartë ligjor aplikon dispozita të shfuqizuara të Ligjit mbi marrëdhënien e punës i KSAK-se Nr. 12/89 [tutje referuar si “Ligji mbi Marrëdhënien e Punës”].
71. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikon se kontesti i punës ka filluar në vitin 2008 dhe, sipas tij, legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, përfshin: “(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Më konkretisht, në atë kohe është aplikuar Ligji Themelor i Punës i shpallur me Rregulloren e UNMIK 2001/27 me date 8 tetor 2001. Neni 27 i këtij Ligji përcakton se “Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.” Rrjedhimisht, përderisa Ligji Themelor i Punës ka rregulluar një çështje nga marrëdhënia e punës, dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës nuk kanë gjetur zbatim. Tutje, Ligji Themelor i Punës, përmes nenit 11 rregullon në detaj shkëputjen e kontratës së punës dhe përmbajtjen e njoftimit mbi shkëputjen e kontratës së punës”.
72. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “Përkundër ekzistimit të dispozitave të qarta ligjore, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e kontestuar nuk arrinë të arsyetojë me qartësi se cilat dispozita ligjore zbatohen në rastin konkret”.
73. Parashtruesi i kërkesës specifikon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i “paqartë dhe i mangët” për arsye se në njërën anë përcakton që: “[...] dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës nuk zbatohet kur bien në kundërshtim me Ligjin Themelor të Punës, dhe në anën tjetër aprovon konkludimet e Gjykatave të instancës më të ulët të cilat realisht në tërësi kanë shpërfillur dispozitat e Ligjit Themelor të Punës”.
74. Tutje, parashtruesi i kërkesës nënvizon se Aktgjykimi i kontestuar: “[...] përveç që aplikon dispozitat e shfuqizuara të një ligji, aplikon edhe dispozitat e ligjit në fuqi, pra Ligjit Themelor të Punës, por pa arritur të arsyetojë ndërlidhjen logjike në mes fakteve të rastit dhe dispozitave ligjore të aplikueshme”.

75. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykim i Gjykatës Supreme nuk ka adresuar pretendimet e tij përkitazi me aplikimin e dispozitave të Ligjit Themelor të Punës, bazuar në të cilin ishte nxjerrë edhe Njoftimi, i 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës.
76. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij të lartcekura për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor i mbështet duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht rasteve KI87/18, parashtrues *"IF Skadeforisikring"* (Aktgjykim, i 15 prillit 2019); KI35/18, parashtrues *"Bayerische Versicherungsverband"* (Aktgjykim, i 6 janarit 2020); KI135/14, parashtrues *IKK Classic* (Aktgjykim, i 10 nëntorit 2015); dhe KI72/12, parashtrues *Veton dhe Ilfete Haziri* (Aktgjykim, i 5 dhjetorit 2012); dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), rastit *Higgins dhe të tjerët kundër Francës* (Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998); *Van de Hurk kundër Holandës* (Aktgjykimi i 19 Prillit 1994); *Buzescu kundër Rumanisë* (Aktgjykimi i 24 majit 2005).

Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencave në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme

77. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se ka hulumtuar mbi praktiken gjyqësore të Gjykatës Supreme në rastet me çështje të njëjtë faktike dhe juridike si në rastin konkret. Bazuar në këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *"[...]Gjykata Supreme ka nxjerre vendime dhe arsyetime krejtësisht të ndryshme nga vendimi dhe arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar"*. Tutje, parashtruesi i kërkesës nënvizon se *"Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme përcakton se në kontestet para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, e njëjta në mënyrë konsistente zbaton vetëm dispozitat relevante të Ligjit Themelor të Punës, Rregullorja e UNMIK 2001/27 në rastet e shkëputjes së kontratës së punës për shkak të shkeljeve të renda. Si rrjedhojë e divergjencës në vendimmarrje, është shkelur edhe e drejta për siguri juridike si garanci e vendosur me të drejtën për gjykim të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së"*.
78. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet pesë (5) Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit [Rev.nr. 377/2018] të 20 nëntorit 2018; Aktgjykimit [Rev.nr. 212/2019] të 11 korrikut 2019; Aktgjykimit [Rev. nr. 1/2019] të 26 shkurtit 2019; Aktgjykimit [Rev. nr. 52/2019] të 11 marsit 2019; dhe Aktgjykimit [Rev.nr. 60/2020] të 6 prillit 2020.
79. Në lidhje me Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të cekura si më lart, parashtruesi i kërkesës po ashtu nënvizon se: *"[...] edhe pas nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykime në situata faktike dhe juridike të njëjta me rastin konkret, në përputhje me praktiken e konsoliduar para nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar. Vetëm në Aktgjykimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka devijuar nga praktika e saj gjyqësore"*.
80. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, të reflektuar me Aktgjykimet e lartcekura, dhe në kontekst të kësaj duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, konsideron se praktika e Gjykatës Supreme në krahasim me Aktgjykimin e

kontestuar shpërfaq: (i) divergjenca të thella dhe afatgjata: “...përkitazi me dispozitat ligjore që aplikohen në kontestet e marrëdhënies së punës të paraqitura para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03/L 212, ne krahasim me dispozitat ligjore që aplikohen në Aktgjykimin e kontestuar”; dhe (ii) mekanizmat e përcaktuar ligjor për tejkalimin e kundërthënieve nuk janë zbatuar nga Gjykata Supreme. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës janë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara për të vlerësuar nëse: “...devijimet nga praktika duke gjykuar në instancë të fundit, shkelin kërkesën për gjykim të drejtë”.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të së “drejtës për trajtim të barabartë” për shkak të dallimeve diskriminuese të trajtimit të rasteve tërësisht të njëjta

81. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se: “Sipas analizës krahasimore të paraqitur me lart, është e dukshme se në të gjitha kontestet e marrëdhënies së punës me situatën e njëjtë faktike dhe juridike, si palë e paditur apo punëdhënëse është Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. [tutje referuar si “KEK”]. Sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, KEK është ndërmarrje publike qendrore. Parashtruesi i kërkesës vëren se në të gjitha këto raste, Gjykata Supreme e Kosovës ka aplikuar vetëm Ligjin Themelor të Punës, duke konkluduar se Ligji mbi Marrëdhënien e Punës nuk gjen zbatim. Si rrjedhojë, në të gjitha rastet është vendosur në favor të palës së paditur - KEK, ndërkaq në rastin e [parashtruesit të kërkesës] e cila është ndërmarrje private, është vendosur ndryshe”.
82. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet përmbajtjes së nenit 24 të Kushtetutës, duke nënvizuar se: “Ky nen garanton barazinë e të gjithë personave para ligjit dhe përcakton të drejtën për mbrojtje të barabartë gjyqësore, pa asnjë dallim në mes tyre. Në fakt qëllimi i këtij neni është ndalimi i diskriminimit, si parakusht themelor i sigurimit të respektimit të të gjitha të drejtave tjera të njeriut që i garanton Kushtetuta”. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës K104/12 me parashtrues Esat Kelmendi, në të cilin rast Gjykata ndër të tjerash kishte konstatuar edhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.
83. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se ai është: “...vënë në pozitë të pabarabartë me persona të tjerë, përkatësisht me KEK, i cili fitoi rastet e veta me të njëjtën situatë faktike e bazë ligjore, sikurse të [parashtruesit të kërkesës]”.
84. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) kërkesën e tij ta shpallë të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24, dhe nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës Supreme; dhe (iv) çështjen ta kthejë në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Kërkesa për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, më 27 prill 2021, në Gjykatë kishte dorëzuar: “Parashtresë për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.12/2020 i datës 19 shkurt 2020”. Parashtresën e saj, përfaqësuesja

ligjore, e kishte mbështetur në rregullin 34 [Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës.

86. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë specifikon se:

“Përmirësimi vjen si rrjedhojë e një gabimi teknik në paragrafin 26 të Kërkesës së paraqitur përmes formularit përkatës, gjegjësisht pjesa III Arsytimi i Kërkesës dhe Shkeljet e Pretenduara të Kushtetutës. Paragrafi 26, përmirësohet ashtu që fjalia e parë e paragrafit zëvendësohet me fjalinë në vijim:

*"Në bazë të analizës së aktgjykimeve të lartcekura, është me se evidente se në rastet me rrethana faktike dhe juridike të njëjta, Gjykata **Supreme** ka nxjerre aktgjykime me arsytetime të cilat dallojnë nga Aktgjykimi i kontestuar si para nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar, ashtu edhe pas nxjerrjes së tij".*

Pjesa vijuese e paragrafit 26 mbetet e pandryshuar”.

87. Parashtruesi i kërkesës vazhdon: *“Ndërkaq, plotësimi vjen si rrjedhojë e Aktgjykimit Rev .nr.1 04/20 i nxjerre me datë 25 shkurt 2021 nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe e pranuar nga Parashtruesja e Kërkesës me datë 23 prill 2021. Aktgjykimi në fjale i jep epilog kontestit me rrethana faktike dhe baze ligjore identike me Aktgjykimin Rev. Nr. 12/2020 i datës 19 shkurt 2020, ndaj të cilit Parashtruesja e Kërkesës ka paraqitur Kërkesën për Vlerësim të Kushtetutshmërisë. Me saktësisht, Aktgjykimi Rev. nr. 104/2020 i datës 25 shkurt 2021 ka të bëjë më çështjen juridike kontestimore të paditësit S.R [...] kundër të paditurës Raiffeisen Bank në Kosovë. Në rastin në fjalë, Raiffesien Bank kishte shkëputur kontratën e punës së paditësit S.R, meqë i njëjti bashke me kolegun e tij F.S pa autorizim i kishin dhënë mjetet financiare të Raiffeisen Bank klientit Xh.B pronar i kembimores "M" në shumë prej EUR 87,000.00. Ndaj njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës, që të dy kishin paraqitur padi duke kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi i Raiffeisen Bank për shkëputje të kontratës së punës. Përderisa çështjen kontestimore ku paditës është F.S Gjykata Supreme kishte refuzuar revizionin e ushtruar nga Raiffeisen Bank, në çështjen tjetër kontestimore ku paditës është S.R, Gjykata Supreme ka pranuar revizionin e ushtruar nga Raiffeisen Bank. Te dyja çështjet kontestimore kanë fakte identike dhe baze ligjore të njëjtë. Përkundër kësaj, Raiffeisen Bank ka pranuar dy Aktgjykime krejtësisht të kundërta me njëra tjetrën”.*

88. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se paraqet këtë plotësim të Kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.12/2020, të shkurtit 2020. Me saktësisht, plotësohet paragrafi 50 i Kërkesës, pika a) përcaktimi nëse ekzistojnë *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktiken gjyqësore të gjykatave të vendit, duke shtuar analizën krahasuese edhe me përmbajtjen e Aktgjykimit nr. 104/2020 të 25 shkurtit 2021.

89. Pas përmbledhjes së përmbajtjes së këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës përfundon se: *“Është e qartë se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. Nr 104/20 i datës 25 shkurt 2021, ndryshe nga Aktgjykimi Rev. nr. 12/2020 i datës 19 shkurt 2020, i cili është në proces të vlerësimit kushtetues, ka zbatuar vetëm*

dispozitat e Ligjit Themelor të Punës, përkatësisht Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 e datës 12 dhjetor 1999”.

Kërkesa për masë të përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ac.nr. 1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit

90. Gjykata rikujton se, më 7 mars 2022, parashtuesi i kërkesës në Gjykatë ka parashtuar kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ac. nr. 1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë në procedurë kontestimore. Gjykata përsërit se procedura e zhvilluar kontestimore, i referohet pikës së parë të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës kjo e fundit kishte vendosur:

“Pranohet, si pjesërisht i bazuar revizioni i të paditurës “Raiffeisen Bank” [parashtuesi i kërkesës], dhe Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [...]dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C. Nr. 593/2014 datë 21 shtator 2015 në pjesën III të dispozitivit që ka të bëjë me detyrimin e [parashtuesit të kërkesës] që paditësin ta kthejë në pozitën që ka qenë duke punuar, si zëvendës të menaxherit të bankës Raiffeisen Banka-Dega në Prizren dhe për këtë pjesë, çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.”

91. Gjykata vë në pah se pika e parë e dispozitivit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nuk është objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtuesit të kërkesës, pasi që parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij të dorëzuar më 17 shtator 2020 në Gjykatë kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së pikës së dytë të Aktgjykimit [Rev. nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës kishte vendosur që:

“Refuzohet si i pabazuar revizioni [i parashtuesit të kërkesës] kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. Nr. 484/2016 datë 18 shtator 2019, përkitazi me pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C. Nr. 593/2014 datë 21 shtator 2015, që k atë bëjë me anulimin si të kundërligjshme të njoftimit [të parashtuesit të kërkesës], të datës 21 prill 2008për shkëputjen e kontatës së punës së paditësit.”

92. Parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij, të 7 marsit 2022, për caktimin e masës së përkohshme arsyeton se: *“Nga data e paraqitjes se Kërkesës për Vlerësim të Kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të kontestuar konkretisht 17.09.2020, e deri me pranimin e Propozimit me Urdhër për lejimin e ekzekutimit në baze të titullit përmbarimor, vlera 199,398.00 Eur kanë kaluar me shume se 1 vit e 5 muaj. Duke marrë për baze përvojën paraprake me shqyrtimin e lëndëve, si dhe praktikën e deritanishme në lidhje me kohëzgjatjen e vendimmarrjes, Parashtuesja e Kërkesës ka vlerësuar se Gjykata Kushtetuese do të vendosë në çështjen në fjale me shpejt se sa gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në rigjykimKy vlerësim bazohet në faktin se procedura kontestimore e zhvilluar në çështjen në fjale, fillimisht ka marrë 12 vite duke e llogaritur nga paraqitja e kërkesëpadisë (2008), e deri tek Aktgjykimi i kontestuar (2020). Ndërkaq, në procedurë të rigjykimit, procedura është zhvilluar për më pak se 2 vite, duke e llogaritur nga nxjerrja e Aktgjykimit të kontestuar e deri tek nxjerrja e Aktgjykimit CA. nr. 1578/2021 i datës 10.01.2022. Andaj, me rastin e paraqitjes*

se Kërkesës për Vlerësim të Kushtetutshmërisë, Parashtruesja e Kërkesës nuk e ka parë të nevojshme paraqitjen e kërkesës për caktim të masës së përkohshme”.

93. Parashtruesi i kërkesës, më tej arsyeton se: “[...] përmbarimi i Aktgjykimit CA.nr. 1578/2021 i datës 10.01 .2022 do të shkaktonte dëme të pa-riparueshme financiare në shume prej 199,398.00 Eur. Shuma në fjalë paraqet barrë tejet të lartë për Parashtruesen e Kërkesës. Përmbarimi i shumës së lartcekur do të nënkuptonte se paditësi [F.S] do të pranonte mjetet monetare në fjalë, me c’rast automatikisht fiton të drejtën e disponimit të tyre lirshëm. Po qe se Gjykata Kushtetuese përmes aktgjykimit deklaron si të pranueshme Kërkesën për Vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar si dhe konstaton se ka pasur shkelje, atëherë dokumenti përmbarues gjegjësisht Aktgjykimi CA.Nr. 1578/2021 anulohet dhe nuk prodhon efekt juridik’. Sidoqoftë për Parashtruesen e Kërkesës, kundër përmbarimi si mjet ligjor do të ishte i paefektshëm meqë paditësi [F.S] mjetet e pranuar në përmbarim do t’i shpenzonte, tjetërsonte, investonte tërësisht apo pjesërisht. Paditësi [F.S] është i gjendjes ekonomike mesatare dhe nuk ka në pronësi pasuri ekuivalente me shumën e lejuar me urdhër përmbarimor që të mundësonte eventualisht kundërpërmbarimin nga Parashtruesja e Kërkesës”.
94. Më tej, parashtruesi i kërkesës pohon se: “Kthimi eventual në vend të punës, dhe largimi i sërishëm do të shkaktonte dëm jo vetëm financiar. Për Parashtruesen e Kërkesës do të jetë sfidë të integrojë në vend pune një ish të punësuar i cili nëkundërshtim me të gjitha rregullat e vendit të punës, dhe ligjet në fuqi, ka keqpërdorur mjetet monetare të bankës, gjegjësisht depozituesve, për interes dhe benefit të palëve të treta. Njëkohësisht të gjithë stafit dhe ish koleget e paditësit janë në dijeni për rastin në fjalë, dhe rikthimi në vend të punës i një ish të punësuarit të tillë do të ishte tejet demoralizues për të gjithë të punësuarit tjerë të cilët detyrat e punës i kryejnë me nder dhe përpikëmeri. Andaj, për Parashtruesen e Kërkesës kthimi në vend pune përderisa çështja është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese do të ishte dëm i pariparueshëm.”
95. Tutje, parashtruesi i kërkesës po ashtu nënvizon se: “[...] Mbetet e paqartë se cila është arsyeja që Gjykata Themelore në Prizren ka lëshuar një urdhër të tillë, kur dihet qartë se bankat gëzojnë likuiditet të mjaftueshëm për përmblotjen e detyrimeve financiare ligjore, dhe rrjedhimisht nuk ekziston kurrfarë rreziku që ekzekutimi të mos jetë i suksesshëm si pasojë e mungesës së mjeteve. Bllokimi i llogarive të Parashtrueses së kërkesës është masë e karakterit të rëndë e cila do të vë në rrezik serioz të gjithë transaksionet e klientëve dhe sistemin financiar. Rrjedhimisht edhe dëmi është i pa-riparueshëm”.
96. Në fund të kërkesës së tij për masë të përkohshme, parashtruesi i kërkesës po ashtu konsideron se: “[...] caktimi i masës së përkohshme në këtë rast është në interes publik për shkak të rëndësisë së të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetut dhe interesin e administrimit të duhur të drejtësisë, dhe ruajtjes së sistemit financiar. Andaj, pa paragjykuar ndaj vendimeve tjera që do të nxirren nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me pranueshmërinë, apo meritat e kërkesës, masa e përkohshme duhet nxjerrë ashtu që të mbrohet interesi publik i administrimit të duhur të drejtësisë”.

97. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës propozon vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ca. nr. 1578/2021] të 10 janarit 2021 të Gjykatës së Apelit duke kërkuar që: "[...] të stopojë çdo procedure përmbartimore, veprim të autoriteteve publike që burojnë nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës".

Përgjigja e Gjykatës Supreme, e dorëzuar më 10 tetor 2021

98. Gjykata rikujton se më 7 tetor 2021 përkitazi me kërkesën e tanishme, respektivisht KI133/20 dhe kërkesën KI78/21 i dërgoi Gjykatës Supreme kërkesën për përgjigje në pyetjet: (i) *Për aq sa është e mundur, luteni që ta njoftoni Gjykatën përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, të KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] dhe (ii) Luteni që të na sqaroni se cila është praktika relevante gjyqësore përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK-ut, të vitit 1989 dhe dispozitave të Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës përmes Njoftimit të Punëdhënësit, si rezultat i konstatimit të shkeljeve të detyrave të punës nga punëmarrësit. Më konkretisht, luteni të na sqaroni se a ka Gjykata Supreme një praktikë gjyqësore të unifikuar në këso raste apo çështja e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, i KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] shqyrtohet nga rasti në rast. Nëse Gjykata Supreme ka një praktikë të unifikuar dhe konsistente në lidhje me çështjet e sipërcekura, luteni që po ashtu të na sqaroni se nga cila periudhë saktësisht ka filluar unifikimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.*
99. Në përgjigjen e saj, të dorëzuar më 10 tetor 2021, Gjykata Supreme ndaj pyetjeve të Gjykatës u përgjigj si në vijim:

"Fillimisht ju njoftojmë se në çështje të interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të dy Ligjeve të lartpërmendura në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës përmes njoftimit të punëdhënësit, si rezultat i konstatimit të shkeljeve të detyrave të punës nga punëmarrësit, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk ka një praktikë gjyqësore të unifikuar por interpretimi i këtyre dy Ligjeve, në rastet e lartpërmendura, bëhet për secilin rast të veçantë, thjeshtë nga rasti në rast. Megjithatë, duhet sqaruar se brenda për brenda kolegjeve të Gjykatës Supreme, në çështjet civile, ekziston një konsensus si në vijim: Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës, i KSAK m. 12/89, dhe Ligji Themelor i Punës (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27) ka qenë në fuqi deri me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës më datë 17.12.2010 i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 90 më datë 1.12.2010, kur me nenin 99 par. I të këtij Ligji parashihet që „Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27), Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 (fjala është për këtë Ligj i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 12/89) dhe Ligji i Punës i Jugosllavisë i vitit 1977 me amandamentet përkatëse.

Nga kjo dispozitë rezulton se Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 ka qenë në fuqi dhe në zbatim deri me nxjerrjen e Ligjit të Ri mbi

Punën të vitit 2010, mirëpo, ai në tërësinë e tij nuk ka pasur mundësi të zbatohet, kjo ngase me nenin 27 të Ligjit themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27) parashihet që kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të Ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të. Për faktin se me këtë Ligj Themelor të Punës të vitit 2001, nuk është paraparë fare procedurë disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës nga punëmarrësi, Gjykata Supreme ka konsideruar se konstatimi i këtyre shkeljeve të rënda, kryerja e tyre nga punëmarrësi, dhe përgjegjësia për kryerjen e tyre, duhet të vërtetohet në procedurë disiplinore të cilën e parasheh Ligji për Marrëdhënien e Punës i lartpërmendur, pasi që Ligji Themelor i Punës i vitit 2001, nuk parasheh fare procedurë disiplinore, as mënyrën e konstatimit të këtyre shkeljeve disiplinore, e as autoritetin e punëdhënësit i cili shqipton masa disiplinore për shkelje të ndryshme disiplinore. Tani me Ligjin e punës të vitit 2010 situatën e kemi plotësisht të qartë, nga se nuk parashihet fare procedura disiplinore, por punëdhënësve ill mbetet që me aktet e Ëre të brendshme të nxjerrin rregullore për procedurë disiplinore.

Kjo do të thotë se në aspektin e procedurës disiplinore në mënyrë plotësuese në praktikë është zbatuar edhe Ligji për Marrëdhënien e Punës i vitit 1989. Në këtë situatë në praktikë, megjithatë, Gjykata Supreme ka bërë disa dallime prej rastit në rast, kështu p.sh. në 5 rastet e përshkruara në shkresat përcjellëse të kërkesës për dhënien e këtij njoftimi, në të cilat Gjykata Supreme ka nxjerrë aktgjykim, të cilat kanë të bëjnë me kontestin në mes të punëmarrësve dhe KEDS-it, kjo Gjykatë ka përfunduar se për faktin që me rastin e auditimit të brendshëm, kontrollit të brendshëm të KEDS-it, përmes komisioneve ad-hoc është vërtetuar saktësisht shkelja disiplinore e punëmarrësve të cilat kanë pasur të bëjnë me vjedhjen e pasurisë së KEDS-it, energjisë elektrike, duke mos bllobuar njehsorët elektrikë apo duke intervenuar në kundërshtim me Ligjin në ata njehsorë dhe në mënyrat tjera, fakte këto që kontrolli i brendshëm i ka vërtetuar edhe përmes kontrollimit profesional të këtyre njehsorëve me "bazhdarim", ka rezultuar se gjendja faktike është vërtetuar plotësisht dhe saktësisht sa i përket shkeljeve disiplinore, ndërsa sanksionin disiplinor e ka shqiptuar organi i shkallës së parë dhe i dytë ashtu siç parashihet më afër me Rregulloren e brendshme dhe me Kodin disiplinor të KEDS-it. Për më tepër, me këto dy akte juridike të brendshme të KEDS-it parashihet që në këto raste procedura është e shkurtër, kështu që Gjykata Supreme ka arsyetuar mos zhvillimin e një procedure shumë të veçantë disiplinore krahas vërtetimit të saktë dhe të drejtë të gjendjes faktike nga auditori respektivisht kontrolli i brendshëm i KEDS-it, duke ardhur kështu në një përfundim se nuk ka arbitrarizëm me rastin e shqiptimit të sanksionit disiplinor ndaj punëmarrësit përgjegjës, Shkelja disiplinore dhe përgjegjësia e të cilit është konstatuar nga ana e auditorit të brendshëm të punëdhënësit.

Lidhur me dy aktgjykimet që janë në procedurë në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të jap asnjë sqarim, ngase për to është thënë gjithçka në ato aktgjykime dhe nuk pretendojmë të ndërhyjmë në asnjë mënyrë."

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në

proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]

Ligji për Marrëdhënien e Punës [Gazeta Zyrtare KSAK nr. 12/89]

Neni 73

Gjatë kohës së ndërprerjes së punës që është shkaktuar pa fajin e punëtorit, punëtori gëzon të drejtën e shpërblimit të të ardhurave personale, punëtorit ti takon e drejta e shpërblimit të të ardhurave mesatare personale të realizuar anë tre muajt e fundit.
[...]

Kreu VIII PËRGJEGJËSIA E PUNËTORIT

1. Përgjegjësia për shkak të shkeljes së detyrës së punës

Neni 111

Me hyrjen në punë në organizatën themelore punëtori i merr përsipër detyrimet në punë në lidhje me punë [obligimet e punës], të përcaktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të organizatës themelore dhe me ligj.

Punëtori përgjigjet vetëm për shkeljen e obligimit të punës i cili në kohën e kryerjes ka qenë i përcaktuar me dispozita dhe me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës të organizatës themelore.

Neni 112

Organet e autorizuara kanë për detyrë të paraqesin kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore brenda tetë ditësh pasi të marrin vesh për shkeljen e detyrës së punës dhe për kryesin.

Komisioni disiplinor ka për detyrë që kërkesën për iniciimin e procedurës ta shqyrtojë dhe ta marrë për procedurë brenda 15 ditësh pasi të paraqitet kërkesa.

Procedura disiplinore është urgjente.

Neni 113

Organi punëdrejtues, respektivisht punëtori i caktuar me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta mundet për shkelje të lehtë të detyrave të punës t'i shqyrtojë masën disiplinore vërejtje dhe vërejtje publike dhe punëtorin ta largojë përkohësisht nga organizata themelore, respektivisht nga punët dhe detyrat e punës në kushte dhe në mënyrën e saktësuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës.

Para se të shqiptojë masën disiplinore, respektivisht të largojë punëtorin nga puna nga paragrafi 1 i këtij neni, organi punëdrejtues, respektivisht punëtori i caktuar me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta ka për detyrë të marrë në pyetje punëtorin.

Kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore dhe largimin nga puna nga paragrafi 1 i këtij neni, punëtori mund t'i paraqet kundërshtim organit kompetent në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit për masën e shqiptuar, respektivisht të largimit të përkohshëm.

Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë

Neni 11

Shkëputja e kontratës së punës

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

- (a) me rastin e vdekjes së punonjësit;*
- (b) me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;*
- (c) në rastet e rënda të sjelles së keqe nga punonjësit;*
- (ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;*
- (d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe*
- (dh) sipas fuqisë ligjore.*

11.2 Kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi.

11.3 Raste të rënda të sjelljes së keqe paraqesin:

- (a) kundërshtimi i paarsyetuar për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;*
- (b) vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit;*
- (c) zbulimi i fshehtësive afariste;*
- (ç) përdorimi i drogave dhe i alkoolit në punë dhe*
- (d) sjellja e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej.*

11.4 Përmbushja e pakënaqshme e detyrave të punës përfshin sa vijon:

- (a) mungesën e paarsyeshme nga puna dhe*
- (b) gabimet e përsëritura, të cilat si të tilla nuk janë të mjaftueshme për ta arsyetuar largimin nga puna por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës.*

11.5 Në rastet kur zbatohet neni 11.2: (a) punëdhënësi do ta njoftojë punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshinë edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe (b) punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me ç'rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punonjësi është anëtar i ndonjë sindikate ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës.

11.6 Kontrata e punës shkëputet sipas fuqisë ligjore në rastet kur punëdhënësi konstaton se punonjësi për shkaqe shëndetësore nuk mund ta kryejë më punën ose shërbimet për të cilat ai ose ajo është punësuar dhe kur nuk ka punë tjetër

të cilën ai ose ajo do të ishte në gjendje ta kryente. Punëdhënësi duhet ta paralajmërojë punonjësin një muaj përpara shkëputjes së kontratës.

11.7 Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje.

11.8 Në rastet e shkëputjes së kontratës së punës, punëdhënësi, me kërkesë të punonjësit, e pajisë atë me një vërtetim ku figuron emri i punonjësit, natyra e punës ose lloji i punës ose i shërbimeve për të cilat ai ose ajo është punësuar, periudha kohore e punësimit, lartësia bazë e pagës/rrogës me pagesat dhe të ardhurat tjera si dhe një vlerësim për përmbushjen e detyrave të punës gjatë kohës së punësimit.

[...]

Neni 27
Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 8 tetor 2001.

Rregullore e UNMIK-ut nr. 1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë, e miratuar më 12 dhjetor 1999

Neni 1
Ligji në fuqi

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 qershor 1999.

Vlerësimi i kërkesës për plotësimin dhe përmirësimin e kërkesës dhe të pranueshmërisë së kërkesës

(i) Vlerësimi i kërkesës për plotësimin dhe përmirësimin e kërkesës

100. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës së tij, të parashtruar më 27 prill 2021, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në rregullin 34 [Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës kishte parashtruar kërkesë për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës, së parashtruar më 17 shtator 2020. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kjo parashtrësë nuk përmbante kërkesë për përmirësim të gabimeve teknike ose numerike, por përmbante plotësimin e pretendimit të tij në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i praktikës kundërthënëse në Gjykatën Supreme, duke e mbështetur këtë të fundit më dorëzimin e një kopjeje të Aktgjykimit [Rev. nr. 104/20] të 25 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme, i cili Aktgjykim nga kjo gjykatë ishte nxjerrë pas dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatën Kushtetuese.
101. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës, i cili përcakton që: *“Në qfarëdo kohe, para se gjyqtari raportues të ketë paraqitur raportin e tij, pala, e cila e ka parashtruar kërkesën, ose Gjykata ex officio, mund të dorëzojë në Sekretariat përmirësimin e gabimeve teknike ose numerike në materialin e parashtruar”*.
102. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit) të Rregullores së punës që përcaktojnë:

Neni 22

[Procedimi i kërkesës]

“4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.”

Rregulli 33

(Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit)

[...]

(2) Nëse një kërkesë nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme, Gjyqtari raportues nëpërmjet Sekretariatit e njofton parashtruesin e kërkesës, kontaktet e të cilit janë të njohura, se kërkesa duhet të plotësohet me dokumentet e specifikuar në kërkesë dhe përcakton saktë se këto dokumente duhet të dorëzohen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e parashtrimi të kërkesës.

(3) Përveç nëse kërkohet nga Gjykata ose, nëse merret leje me shkrim nga Gjykata, pala nuk mund të dorëzojë asnjë dokument pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimi të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër, kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar.”

[...]

103. Gjykata, duke u bazuar në paragrafin (1) të rregullit 33 të Rregullores së punës, përsërit se parashtrësja e parashtruesit të kërkesës e dorëzuar më 27 prill 2021 përmban plotësimin e pretendimit si në vijim:

“Përmiresimi ujen si rrjedhojë e nje gabimi teknik në paragrafin 26 të Kërkeses se paraqitur përmes Formularit përkates, gjegjesisht pjesa III Arsytimi i Kërkesës dhe Shkeljet e Pretenduara të Kushtetutës. Paragrafi 26, përmiresohet ashtu që fjalia e parë e paragrafit zëvendësohet me fjalinë në vijim :

"Në bazë të analizës së aktgjykimeve të lartcekura, është më se evidente se në rastet me rrethana faktike dhe juridike të njëjta, Gjykata Supreme ka nxjerrë aktgjykime me arsyetime të cilat dallojnë nga Aktgjykimi i kontestuar si para nxjerrjes se Aktgjykimit të kontestuar, ashtu edhe pas nxjerrjes së tij.

Pjesa vijuese e paragrafit 26 mbetet e pandryshuar. »

104. Ndërsa përkiazi me plotësimin e kërkesës, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë ka dorëzuar edhe kopjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 104/20] të 25 shkurtit 2021 të nxjerrë nga Gjykata Supreme pas parashtrimit të kërkesës së tij më 17 shtator 2020.
105. Në dritën e eleaborimit si më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës për plotësimin e kërkesës është dorëzuar jashtë afateve procedurale dhe bie jashtë fushëveprimit të rregullave të sipërcekura, dhe kjo për arsye se kërkesa fillestare është dorëzuar më 17 shtator 2020, ndërsa dokumentet shtesë për plotësimin e pretendimit të saj janë dorëzuar më 27 prill 2021. Për me tepër, parashtruesi e dorëzuar më 27 prill 2021 nuk ka të bëjë me përmirësimin e gabimeve teknike apo numerike të kërkesës fillestare, por ndërlihet me plotësimin e pretendimit dhe dorëzimin e informatës shtesë. Rrjedhimisht, Gjykata do të vazhdojë më shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur në kërkesën e dorëzuar më 17 shtator 2020.

(ii) Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

106. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
107. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

108. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

109. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, respektivisht të institucionit bankar ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

110. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev. nir. 12/20], të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës Supreme. Në lidhje me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata rikujton se kjo e fundit çështjen e kishte kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, respektivisht në Gjykatën Themelore. Megjithatë, në lidhje me pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, të cilin e konteston parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se ky Aktgjykim në këtë pikë është përfundimtar, dhe rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
111. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës gjithashtu i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Meritat e kërkesës

112. Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Njoftimin e parashtruesit të kërkesës, të 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës së F.S.. Për pasojë, më 29 maj 2008, F.S. kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prizren, përmes së cilës kishte kërkuar anulimin e Njoftimit, të 21 prillit 2008, dhe kishte kërkuar kthimin në vendin e saj të mëparshëm të punës. Në të njëjtën kohë, kundër F.S. ishte zhvilluar edhe procedura penale, e cila përfundimisht përmes Aktgjykimit [PA.II.nr.2/2014], të 6 majit 2014, të Gjykatës Supreme ishte konstatuar se vepra penale për të cilën F.S. akuzohej kishte arritur parashkrimin absolut dhe për pasojë e refuzoi akuzën e ngritur ndaj saj. Përkitazi me kërkesëpadinë e F.S. të zhvilluar në kuadër të procedurës kontestimore, më 21 shtator 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr. 593/14] kishte: (i) aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e F.S.; (ii) kishte anuluar si të kundërligjshëm Njoftimin, e 21 prillit 2008, të parashtruesit të kërkesës për shkëputjen e kontratës së punës; dhe (iii) kishte detyruar parashtruesin e kërkesës që F.S. ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, duke ia kompensuar edhe pagat për periudhën 21 prill 2008 deri më 21 qershor 2015 në shumë prej 111,916.89 euro. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj fillimisht kishte rikujtuar se Njoftimi, i 21 prillit 2008, i parashtruesit të kërkesës për shkëputjen e kontratës së punës të F.S. ishte bazuar në Ligjin Themelor të Punës [Rregullore e UNMIKU-ut nr. 2001/27], megjithatë në arsyetimin e saj kjo gjykatë kishte konstatuar se Ligji Themelor i Punës [Rregullore e UNMIKU-ut nr. 2001/27] nuk përcakton procedurat në mënyrë të precizuar dhe të detajuar për shkëputje të marrëdhënies së punës dhe duke marrë për bazë kohën e ndërprerjes së kontratës së punës dhe paraqitjen e kërkesëpadisë, ligji i zbatueshëm në këtë rast, sipas kësaj gjykate, është Ligji për Marrëdhënien e Punës të KSAK nr. 12/89 i vitit 1989. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore, bazuar në nenet 111, 112 dhe 113 të Ligjit për Marrëdhënien e Punës nr. 12/89 të vitit 1989 dhe pas administrimit të të gjitha provave përkatëse konstatoi se parashtruesi i kërkesës Njoftimin, e 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës e kishte nxjerrë pa zbatuar procedurën disiplinore në pajtim me procedurat e parapara ligjore për shkeljen e detyrave të punës dhe për pasojë, sipas gjykatës, shqiptimi i masës disiplinore ishte bërë pa u formuar një komision disiplinor. Rrjedhimisht, dhe bazuar në atë si më lart, Gjykata Themelore konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës ishte i paligjshëm. Si rezultat i ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.484/2016]: I. Refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me: (i) Njoftimin, e 21 prillit 2008; dhe (ii) detyrimin për kthim të F.S. në vendin e saj të mëparshëm të punës, dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 593/2-14] e 21 shtatorit 2015, të Gjykatës Themelore. Ndërsa II. pjesërisht aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me: (i) kompensimin e pagave ndaj F.S. për periudhën 21 prill 2008 deri më 21 qershor 2015; (ii) dhe shpenzimet procedurale, dhe në lidhje me këtë prishi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore duke e kthyer lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje. Parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [Ac.nr.484/2016] të Gjykatës së Apelit, gjegjësisht kundër pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar ndër të tjera edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit.

Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikoi se ligji i zbatueshëm përkitazi me shkëputjen e kontratës së punës së F.S. ishte Ligji Themelor i Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27]. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020]: I. Pranoi pjesërisht si të bazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës sa i përket detyrimit për parashtruesin e kërkesës që F.S. ta kthejë në vendin e saj të mëparshëm të punës, dhe për pasojë prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe lëndën e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore; dhe II. Refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me anulimin si të kundërligjshëm të Njoftimit, të 21 prillit 2008, për shkëputjen e kontratës së punës. Përkitazi me pikën e dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme vlerësoi si të drejtë qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se në bazë të nenit 111, paragrafit 2 të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK, nr. 12/89 i punësuarit përgjigjet *“vetëm për shkeljet që kane qenë të normuara me ligj ose akt të brendshëm”*. Së dyti, Gjykata Supreme konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, është i paligjshëm dhe vërtetoi konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se kundër F.S. nuk ishte zhvilluar procedurë disiplinore për të vërtetuar *“përgjegjësinë e saj dhe nuk ishte shqiptuar masa adekuate me shkeljen e paraparë me aktin e brendshëm”*.

113. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta, dhe në mënyrë specifike përkitazi me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit [E.Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2019, të Gjykatës Supreme, pretendon se ky i fundit ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me:

I. Nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të: (i) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) cenimit të parimit të sigurisë juridike, sepse sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme në nxjerrjen e këtij Aktgjykimi kishte vepruar edhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të saj; dhe

II. Nenin 24 të Kushtetutës për shkak të shkeljes së të drejtës së tij për trajtim të barabartë, sipas tij, si rezultat i “dallimeve diskriminuese të trajtimit të rasteve tërësisht të njëjta”.

114. Rrjedhimisht, Gjykata do të fillojë me shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me neni 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe këtë do ta shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

115. Thënë këtë, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me neni 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, Gjykata fillimisht do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme, dhe më pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

I. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat

i mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme

A. Parimet e përgjithshme siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

116. Përkitazi me parimin e sigurisë juridike si rezultat i mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, GJEDNJ në praktikën e saj ka zhvilluar: (i) parimet themelore; dhe (ii) ka vendosur kriteret nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Kriteret e vendosura nga GJEDNJ, Gjykata gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesave për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih, ndër të tjera, rastet e lartcekura të Gjykatës KI35/18 dhe KI87/18, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme; po ashtu, mes tjerash, edhe rastet KI74/19 më parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktgjykim, i 28 prillit 2021; KI119/19 me parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktgjykim, i 28 prillit 2021; dhe KIO9/20 me parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktgjykim, i 28 prillit 2021, aktgjykime të cilat Gjykata në trajtimin e meritave të pretendimeve për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së).
117. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në pah se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka rezultuar në parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore. Në kontekst të kësaj, Gjykata vë në pah se GJEDNJ në rastin e saj *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë* (Aktgjykim, i 10 majit 2012, paragrafi 34) kishte afirmuar të gjitha parimet e vendosura përmes praktikës së saj gjyqësore, duke ritheksuar dhe shtuar si vijon:
- (i) Nuk është funksioni i Gjykatës [GJEDNJ-së] të merret me çështje fakti dhe ligji për të cilat pretendohen se janë bërë nga gjykatat vendore përveç në raste se ato mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me KEDNJ (*duke iu referuar rastit Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi 28). “Ngjashëm, nuk është funksioni i Gjykatës [GJEDNJ-së] përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse ato merren në procedura dukshëm të ngjashme, për shkak se pavarësia e këtyre gjykatave duhet të respektohet” (duke iu referuar rastit *Adamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118);
 - (ii) Mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangie mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangie, nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete (duke iu referuar rastit *Santos Pinto kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 majit 2008);
 - (iii) “Kriteret të cilat e udhëheqin vlerësimin e kushteve nga ana e Gjykatës [GJEDNJ-së] në të cilën vendimet kundërthënëse të vendimmarrjes në shkallë të fundit të gjykatave vendore janë në shkelje të kërkesës për

gjykim të drejtë të mishëruar në nenin 6, paragrafin 1 të Konventës [KEDNJ-së] konsistojnë në përcaktimin nëse në praktikën gjyqësore ekzistojnë “dallime të thella dhe afatgjata”, nëse ligji vendor parasheh mekanizëm për tejkalimin e këtyre kundërthënieve, dhe nëse ky mekanizëm është përdorë, dhe nëse ky është rasti, me çfarë efekti” (duke iu referuar rasteve Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; rasti Beian (nr. 1) kundër Rumanisë, Aktgjykim, i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 34-40; Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë, Aktgjykim, i 27 janarit 2009; Tudor dhe Tudor kundër Rumanisë, Aktgjykim, i 24 marsit 2009, paragrafi 31; dhe Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, Aktgjykim, i 2 nëntorit 2010, paragrafi 36);

- (iv) *Vlerësimi i GJEDNJ-së është bazuar gjithmonë në parimin e sigurisë juridike i cili është i pandashëm në të gjitha nenet e Konventës [KEDNJ-së] dhe përbën një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit (rasti Beian (nr.1), i cituar më lart, paragrafi 39; Iordan dhe Iordanov dhe të tjerët, i cituar më lart, paragrafi 47; Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, i cituar më lart, paragrafi 31);*
- (v) *“Parimi i sigurisë juridike, garanton, ndër tjerash, një siguri të caktuar në situata juridike dhe i kontribuon besimit publik në gjykata. Nxjerrja e vazhdueshme e vendimeve kundërthënëse, në anën tjetër, mund të krijojë një situatë të pasigurisë juridike, që mund të ulë besimin publik në sistemin gjyqësor, përderisa një besim i tillë është qartazi një nga komponentët thelbësorë të një shteti të bazuar në sundim të ligjit” (duke iu referuar rasteve Paduarau kundër Rumanisë, paragrafi 98; Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë, Aktgjykim, 1 dhjetorit 2009, paragrafi 56; Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, i cituar më lart, paragrafi 38);*
- (vi) *Megjithatë kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtjen e besimit legjitim të publikut nuk paraqesin një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore (duke iu referuar rastit Unedić kundër Francës, Aktgjykim, i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 74). Sipas GJEDNJ-së: “zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me administrimin e mirëfilltë të drejtësisë pasi që dështimi për të siguruar një qasje dinamike dhe zhvilluese do të rrezikonte pengesë” (rasti Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Aktgjykim, i 24 qershorit 2010).*

118. GJEDNJ në rastin e saj *Albu kundër Rumanisë*, po ashtu kishte theksuar se nxjerrja e vazhdueshme e vendimeve kundërthënëse, në veçanti kur kundërthënia e ngritur apo pretenduar përfshinë “një numër masiv të parashtruesve, mundet në rrethana të caktuara të krijojë një situatë të pasigurisë juridike, e cila mund të zvogëlojë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, i cili është qartësisht një nga komponentët thelbësorë të një shteti të bazuar në sundim të ligjit”. Sipas GJEDNJ-së: “Divergjencat e qasjes mund të lindin ndërmjet gjykatave si pjesë e procesit të interpretimit të dispozitave ligjore duke i përshtatur ato me situatën materiale. Këto divergjenca mund të tolerohen kur sistemi ligjor vendas është në gjendje t'i përshtatë ato (shih rastin *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin*, të cituar më lart, paragrafët 86-87). Përderisa, përshtatja e divergjencave në raste të izoluara (shih rastin *Karakaya*, të cituar më lart) në praktikë mund të rezultojë më pak kërkuese, megjithatë, kur divergjenca përfshin çështje gjyqësore që prekin një pjesë të madhe të publikut,

*besimi i tyre në sistemin gjyqësor, në veçanti, mund të dëmtohet. Kjo është arsyeja pse sistemi duhet të vendosë mekanizma efektivë që duhet të zbatohen plotësisht dhe menjëherë nëpërmjet gjykatave më të larta përgjegjëse për të garantuar njëllojshmërinë e praktikës gjyqësore, në mënyrë që të korrigjohet në momentin e duhur çdo mospërputhje në vendimet e gjykatave të ndryshme vendore dhe kështu të ruhet besimi i publikut në sistemin gjyqësor” (paragrafi 38 i Aktgjykimit në rastin *Albu kundër Rumanisë*).*

119. Gjykata rikujton se GJEDNJ në zhvillimin e parimeve themelore përmes praktikës së saj gjyqësore ka vendosur tri kritere themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, të cilat kritere janë afirmuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih, në mënyrë specifike, rastet e lartcekura KI35/18 dhe KI87/18). Kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ janë si në vijim:

- (i) nëse ekzistojnë “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore;
- (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe
- (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37-39; *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116-135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituara më lartë, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, paragrafi 39; KI87/18 parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 67; KI35/18 parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 70).

120. Gjykata më tej thekson se koncepti i “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” është shtjelluar nga GJEDNJ, ndër të tjera në rastin *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, rasti ky në të cilin GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 135). Po ashtu GJEDNJ në rastin e saj *Iordan dhe Iordanov kundër Bullgarisë* (Aktgjykim, i 2 korrikut 2009 kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së si rezultat i “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të një gjykate të vetme, përkatësisht Gjykatës Supreme dhe me mospërdorimin e mekanizmit për të siguruar harmonizimin dhe konsistencën e praktikës gjyqësore (shih, në këtë kontekst, edhe rastet e tjera të GJEDNJ-së ku kjo e fundit kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si rezultat i shkeljes së parimit të sigurisë juridike për shkak të praktikës kundërtënëse gjyqësore të gjykatave supreme, *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), i cituar më lart; *Hayati Celebi dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 9 shkurtit 2016; *Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 30 korrikut 2015).

121. Në ilustrimin e rastit të mësipërm, Gjykata vëren se në konstatimin e shkeljes së nenit 6 të KEDNJ-së në kuptim të divergjencës në praktikën gjyqësore, dhe në

përcaktimin nëse ekzistojnë “*dallime të thella dhe afatgjata*”, GJEDNJ-ja gjithashtu morri parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 38; shih, në lidhje me këtë, edhe rastin e Gjykatës KI35/15, me parashtrues *Bayerische Rechtstverband*, të cituar më lart, paragrafi 72).

122. Gjykata në këtë drejtim gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42, 43; shih edhe rastin e Gjykatës KI35/18, të cituar më lart, paragrafi 73).
123. Kjo e fundit ndërlidhet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe me çfarë efekti. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, i cituar më lart, paragrafët 30-32; dhe *Ştefăniţă dhe të tjerët kundër Rumanisë*, i cituar më lart, paragrafët 37-38; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 54). Në këtë drejtim, GJEDNJ ka përsëritur në shumë raste rëndësinë e përcaktimit të mekanizmave për të siguruar konsistencë dhe uniformitet të praktikës gjyqësore të gjykatave. Gjithashtu, ajo ka deklaruar se është përgjegjësi e shteteve për të organizuar sistemet e tyre juridike në mënyrë të tillë që të shmangin divergjencat në praktikën gjyqësore (shih rastet e GJEDNJ-së, *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 24 marsit 2009, paragrafi 58; *Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 23 marsit 2010, paragrafi 86; *Brezovec kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 29 mars 2011, paragrafi 66; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 55). GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se roli i një gjykate supreme është pikërisht për të zgjidhur kundërthënie të tilla (në këtë kontekst, shih rastin e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë (nr. 1)*, cituar më lart, paragrafi 37; *Zielinski dhe Pradal & Gonzalez dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1999; dhe *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 123). Kjo sepse, nëse praktika kundërthënëse zhvillohet brenda një prej autoriteteve më të larta gjyqësore në një vend, vetë ajo gjykatë bëhet burim i pasigurisë juridike, duke minuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe duke e dobësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Beian (nr. 1)*, cituar më lart, paragrafi 39; dhe *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 123). Këto parime të vendosura në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së janë pranuar edhe përmes praktikës së vet Gjykatës në rastet e saj të sipërcekura KI35/18 dhe KI87/18 (shih paragrafin 72 të Aktgjykimit në rastin KI35/18, paragrafi 172).

B. Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

124. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret: (i) kundërthëniet e pretenduara në praktikën gjyqësore janë *“të thella dhe afatgjata”*; dhe (ii) nëse ky është rasti, a ekziston mekanizmi për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.
125. Bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në veçanti në rastin KI35/18, Gjykata gjatë aplikimit të kriterëve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesë do të ketë parasysh parimet themelore përkitazi me konsistencën e praktikës gjyqësore e të elaboruar më lart, rrjedhimisht: (i) rëndësinë e sigurisë juridike; (ii) faktin që parimi i sigurisë juridike dhe rëndësia e konsistencës së praktikës gjyqësore nuk garantojnë një të drejtë në këtë konsistencë në praktikë gjyqësore; (iii) që në fakt, divergjencat në praktikën gjyqësore nuk rezultojnë domosdoshmërisht në shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe me rëndësi (iv) që GJEDNJ konstaton shkelje të tilla, në rast të arbitraritetit të dukshëm (shih paragrafin 75 të Aktgjykimit në rastin e lartcituar të Gjykatës KI35/18).
126. Në këtë kontekst dhe bazuar në si më sipër, Gjykata përsërit, se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave të rregullta.
127. Në aplikimin e parimeve të shtjelluara si më lartë dhe vlerësimin e tri kriterëve të lartcekura, Gjykata: (a) do të rikujtojë rrethanat e shkëputjes së marrëdhënies së punës nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe ligjin e aplikuar në rastin e tij; (b) do të paraqes përmbledhjen e pesë (5) Aktgjykimeve, të dorëzuara nga parashtruesi me kërkesën e tij në Gjykatë më 17 shtator 2020; (c) do t'i referohet përgjigjes së Gjykatës Supreme, të 10 tetorit 2021 .
- (a) Rrethanat e shkëputjes së marrëdhënies së punës nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe ligji i aplikuar në rastin e tij*
128. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës specifikon se kontesti i punës ka filluar në vitin 2008, dhe sipas tij shkëputja e kontratës është bazuar në Ligjin Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27], dhe i cili ligj sipas tij *“përmes nenit 11 rregullon në detaje shkëputjen e kontratës së punës dhe përmbajtjen e njoftimit mbi shkëputjen e kontratës së punës”*. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës specifikon se gjykatat e rregullta, dhe në mënyrë specifike edhe Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar kanë aplikuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, të vitit 1989, për arsye se, sipas tij, ligji i aplikueshëm në rastin e tij ishte vetëm Ligji Themelor i Punës.
129. Në këtë kontekst, dhe përkitazi me ligjet e aplikueshme, Gjykata i referohet Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999 për Ligjin në fuqi në Kosovë, i cili ligj përmes nenit 1 të saj përcaktoi që: *“Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989”*.

130. Në rrethanat e rastit konkret, nga gjykatat e rregullta ishte aplikuar Ligji për Marrëdhënien e Punës, i vitit 1989. Gjykata Themelore, në mënyrë specifike kishte aplikuar nenet 111, 112 dhe 113 të këtij Ligji. Këto dispozita specifike i referohen përgjegjësi dhe mënyrës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit, si rezultat i shkeljeve të detyrave të punës, si dhe të drejtave të punësuarit gjatë zhvillimit të këtyre procedurave.
131. Në këtë aspekt, Gjykata vë në pah se Ligji Themelor i Punës, ishte shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, më 8 tetor 2001. Sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje përcaktohet që: *“Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të”*.
132. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij gjykatat e rregullta është dashur që të aplikojnë Ligjin Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut 2001/27] i cili sipas tij ishte i aplikueshëm në rrethanat e këtij rasti. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtuesi i kërkesës specifikon se Gjykata Supreme ka aplikuar Ligjin Themelor të Punës në rastet që ndërlidhen me rrethana të ngjashme si ato në rastin e tij. Në mbështetje të argumenteve të tij, ai iu referohet dhe ka dorëzuar pesë (5) Aktgjykime të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimin [Rev.nr. 60/2020] të 6 prillit 2020; Aktgjykimin [Rev. nr. 1/2019] të 26 shkurtit 2019; Aktgjykimin [Rev. nr. 52/2019] të 11 marsit 2019; Aktgjykimin [Rev.nr. 212/2019] të 11 korrikut 2019; dhe Aktgjykimin [Rev.nr. 377/2018] të 20 nëntorit 2018.
133. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendimin për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës e ngrit vetëm në kuadër të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.
134. Para analizës nëse: (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. nr.12/2020] i 19 shkurtit 2020 është nxjerrë nga Gjykata Supreme në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore; dhe (ii) nëse rrethanat faktike dhe juridike janë të ngjashme me rastet, të cilat parashtuesi i kërkesës pretendon se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, Gjykata në vijim dhe fillimisht, do t'i paraqesë pjesët relevante të Aktgjykimeve të lartcekura, përkatësisht ato që ndërlidhen me rrethanat e shkëputjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, qëndrimet e gjykatave të rregullta dhe në mënyrë specifike konstatimin e Gjykatës Supreme në lidhje me ligjin e aplikueshëm në rrethanat e këtyre rasteve.

(b) Përmbledhja e pesë (5) Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme

Aktgjykimi [Rev. nr. 60/2020] i 6 prillit 2020, i Gjykatës Supreme

135. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkëputjen e një kontrate ndërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK), në cilësinë e punëdhënësit dhe një të punësuarit të tij për shkak se nga raporti i një kontrolli të brendshëm të kryer nga KEK kishte rezultuar se i punësuarit posedonte njëhisorin e pa bllobuar, i hapur në mënyrë të paautorizuar dhe nga brenda i është vendosur një trake filmike e cila pamundësonte leximin e energjisë elektrike të shpenzuar. Punëdhënësi njoftimin për shkëputjen e kontratës së punë për kohë

të pacaktuar e kishte nxjerrë pas takimit të mbajtur me të punësuarin dhe ndërprerjen e saj e kishte bazuar në nenin 11.3 (b) dhe (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës, respektivisht ndërprerjeje “për shkak të sjelljes së rëndë të keqe”. Si rezultat i kërkesëpadisë së të punësuarit për anulim të Njoftimit të punëdhënësit, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj kishte aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar duke konstatuar se Punëdhënësi [KEK] gabimisht ka zbatuar Rregulloren 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë për shkak se, në këtë rast, ligji i aplikueshëm është Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës, i vitit 1989. Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e punëdhënësit dhe konstatoi se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e të punësuarit të KEK-ut të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke konstatuar se “*gjykata e shkallës së dytë [Gjykata e Apelit] drejt ka përfunduar se njoftimi-vendimi i Menaxherit të Distriktit, i datës 3.9.2010, është ligjërish i drejtë për arsye se paditësi ka bërë shkelej të rëndë të detyrave të punës, sjellje e rëndë e keqe, [...], vjedhja shkatërrimi, dëmtimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit. 2. Sjellje e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e pa arsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës dhe më tej të paraparë me nenin 11.3 (b) dhe (d) të Rregullores nr. 2011/27 për Ligjin Themelor të Punës, dhe vjedhjen e energjisë elektrike nga dispozitat e Rregullores së Punës për Distrikte [të KEK-ut]” dhe “[...] gjykata e shkallës së parë [Gjykata Themelore] gabimisht ka zbatuar Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës nr. 12/1989, kjo për faktin se në kohën e shkëputjes së kontratës së punës së paditësit në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë”.*

Aktgjykimi [Rev. nr 1/2019] i 26 shkurtit 2019, i Gjykatës Supreme

136. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkëputjen e një kontrate ndërmjet (KEK), në cilësinë e punëdhënësit dhe një të punësuarit të tij për shkak se nga raporti i auditimit të brendshëm të kryer nga KEK kishte rezultuar se i punësuarit kishte bërë ndërrimin e përkohshëm të emrave të konsumatorëve pa procedura të përcaktuara ligjore, dhe në të njëjtën ditë këto ndërrime janë kthyer në gjendje të mëparshme. Punëdhënësi njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës për kohë të pacaktuar e kishte nxjerrë pas takimit të mbajtur me të punësuarin dhe ndërprerjen e kontratës së punës e kishte bazuar në shkelje serioze të detyrave të punës në pajtim me nenin 11.2, nenin 11.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës. Si rezultat i kërkesëpadisë së të punësuarit për anulim të Njoftimit të punëdhënësit, Gjykata Themelore në Ferizaj kishte aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar duke konstatuar se kontrata e punës është shkëputur në kundërshtim me nenin 70, paragrafi 4 i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës. Gjykata e Apelit pranoi si të bazuar ankesën e KEK për shkak se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Qëndrimin e saj Gjykata Supreme e arsyetoi si në vijim: “[..] e paditura ka respektuar procedurat e përcaktuara ligjore me rastin e shkëputjes së kontratës së punës së paditësit të përcaktuara me Rregulloren Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë [...]. Veprimet e paditësit paraqesin si raste të sjelljes së keqe të paraparë me nenin 11.3 (d) Rregulloren Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, sjellja e natyrës tepër të

rende pas se cilës do te ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdim i marrëdhënies se punës së paditësit edhe me të. Shkëputja e kontratës së punës se paditësit është bërë në bazë të procedurave të përcaktuara me Rregulloren Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, që ka qenë në fuqi në atë kohë. [...] Lirimi i paditësit nga aktakuza për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale lidhur me këtë rast nuk ka kurrfar ndikimi për faktin se në pyetje janë dy procedura të ndryshme dhe se procedura penale nuk ka ndikim në procedurën disiplinore, interne të [KEK]”.

Aktgjykimi [Rev. nr. 52/2019] i 11 marsit 2019, i Gjykatës Supreme

137. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkëputjen e një kontrate ndërmjet KEK-ut, në cilësinë e punëdhënësit dhe një të punësuarit të tij për shkak se nga raporti i një kontrolli të brendshëm të kryer nga KEK kishte rezultuar se pas auditimit të brendshëm nga KEK, kishin gjetur se tek një konsumator njehsori ishte i pa bllobuar, si dhe ishte gjetur furnizim i dyanshëm me energji elektrike. Punëdhënësi njoftimin për shkëputjen e kontratës së punë për kohë të pacaktuar e kishte nxjerrë pas takimit të mbajtur me të punësuarin, në prani të përfaqësuesit të sindikatës dhe ndërprerjen e saj e kishte bazuar për shkak të mospërmbushjes së kënaqshme të detyrave të punës në bazë të nenit 11.1 paragrafi (b) të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Si rezultat i kërkesëpadisë së të punësuarit për anulim të Njoftimit të punëdhënësit, Gjykata Themelore në Prizren kishte aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar duke konstatuar se punëdhënësi [KEK] gabimisht ka zbatuar Rregulloren 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, për shkak se në këtë rast ligji i aplikueshëm është Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës, i vitit 1989. Gjykata e Apelit kishte aprovuar pjesërisht ankesën e KEK-ut, dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me anulimin si të kundërligjshëm të njoftimit dhe vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjykata Supreme, pranoi si të bazuar revizionin e [KEK], duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës se Apelit si dhe duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e të punësuarit, në cilësinë e paditësit, dhe Aktgjykimin e saj e arsyetoi si në vijim: *"Në këto raste Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar ligjin mbi Marrëdhënien e Punës nr. 12/1989, kjo për faktin se në kohën e shkëputjes së kontratës të punës së paditësit, në fuqi ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë"*.

Aktgjykimi [Rev. nr. 212/2019] i 11 korrikut 2019, i Gjykatës Supreme

138. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkëputjen e një kontrate me kohë të pacaktuar ndërmjet KEK-ut, në cilësinë e punëdhënësit dhe një të punësuarit të tij për shkak se ishte vërtetuar se i punësuarit kishte bërë shfrytëzimin e energjisë elektrike pa të drejtë ashtu që energjia e shpenzuar fare nuk është regjistruar në njehsorin sipas normave të KEK-ut. Menaxheri i KEK-ut pas intervistimit të të punësuarit ia kishte dorëzuar njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës të cilat janë kualifikuar si sjellje e rënde e keqe-vjedhje, shkatërrim, dëmtim ose shfrytëzim i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit ashtu siç ishte përcaktuar më nenin 11.3. pika (b) dhe (d) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe me nenin 8.14 (a) të Rregullores së Punës për Distriktet në KEK. Paditësi, po ashtu kishte paraqitur edhe kundërshtim të Drejtorit të Divizionit të rrjetit në KEK. Gjykata Themelore në Ferizaj kishte konkluduar se shkëputja e kontratës së

punës në mes paditësit dhe KEK-ut, në cilësinë e të paditurës ishte e paligjshme pasi që e paditura nuk ka zhvilluar procedurë disiplinore kundër të punësuarit të saj. Gjykata e Apelit në procedurë ankimore kishte pranuar si të bazuar ankesën e KEK-ut në cilësinë e të paditurës duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë ashtu që kërkesëpadinë e paditësit e kishte refuzuar si të pabazuar pasi që veprimet e të paditurës përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit ishin veprime të ligjshme në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 pikën (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe lidhur me nenin 11 paragrafin 3 pikën (b) e cila i referohet shkëlqes së rëndë të detyrave të punës për shkak të vjedhjes, shkatërrimit, dëmtimit ose shfrytëzimit të paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e paditësit [të punësuarit], të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi se : *"[...] e paditura ka respektuar procedurat e përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ashtu që ne baze te nenit 11.5 për shkeljet e renda te përcaktuara në nenin 11.3 e të njëjtit Ligj, paditësi është njoftuar me njoftim [...] për qëllimin e saj për t'ia ndërprerë paditësit kontratën e punës në baze të pikës (b)[...]"*.

Aktgjykimi [Rev. nr. 377/2018] i 20 nëntorit 2018, i Gjykatës Supreme

139. Përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e paditësit [të punësuarit] paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë sipas të cilit shkëputja e kontratës së punës në mes të punësuarit dhe të paditurës [punëdhënësit KEK] ishte konsideruar si e paligjshme. KEK e kishte njoftuar ish-të punësuarin e saj mbi shkëputjen e kontratës së punës për shkak se ky i fundit kishte bërë ndërrimin e njehsorit elektrik të konsumatorit, pa autorizim dhe në kundërshtim me procedurat për ndërrimin e njehsorëve. Gjykata Themelore në Prishtinë kishte aprovuar kërkesëpadinë e ish-të punësuarit duke arsyetuar se punëdhënësi KEK kishte shqiptuar masë të rëndë përderisa veprimet e të punësuarit kishin të bëjnë me sjelljen në kundërshtim me standarde profesionale dhe etike në vendin e punës. Gjykata e Apelit aprovoi ankesën e KEK-ut dhe konstatoi se Gjykata Themelore në mënyrë të gabuar kishte zbatuar të drejtën materiale. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e paditësit [të punësuarit], dhe arsyetoi se: *"[...] në baze të nenit 11.5 të Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës i cili ka hy ne fuqi me 8 tetor 2001, është përcaktuar se kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi ne rastet e renda të sjelljes së keqe [...]. Punëdhënësi do të njoftoj punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës ashtu që në njoftim theksohet edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës [...]. E paditura në rastin konkret ka respektuar dispozitat e Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosove [...]"*.
140. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës pas dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatë, të 17 shtatorit 2020, më 27 prill 2021 kishte parashtruar në Gjykatë kërkesën për përmirësimin dhe plotësimin e kërkesës. Në kuadër të kërkesës për plotësim të pretendimit të tij që ndërlidhej me pretendimin për divergjencë të praktikës gjyqësore në Gjykatën Supreme, ky i fundit kishte dorëzuar edhe kopjen e Aktgjyimit [Rev. nr. 104/20] të 25 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme.

Këtë kopje të këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar edhe në kërkesën e tij, të regjistruar në Gjykatë me nr. KI78/21.

141. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata tashmë ka konstatuar se plotësimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës. Megjithatë, Gjykata marrë për bazë faktin që parashtruesi i kërkesës edhe në rastin e dorëzuar nga ai, përkatësisht rastin KI78/21 në kontekst të pretendimit të tij për shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i praktikës kundërthënëse të Gjykatës Supreme, përveç dorëzimit të pesë rasteve si ato të lartcekura e të dorëzuara me kërkesën e tij aktuale KI133/20, ka dorëzuar edhe kopjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 104/20] të 25 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vëren se ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme është nxjerrë pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të kontestuar nga ai në këtë kërkesë, dhe i cili i referohet rrethanave të njëjta faktike dhe juridike si të rastit konkret e që për më tepër ndërlidhet me parashtruesin e kërkesës si punëdhënës.

(c) Përgjigja e Gjykatës Supreme, e 10 tetorit 2021

142. Gjykata më 7 tetor 2021, i është drejtuar Gjykatës Supreme me pyetje specifike:

(i) Për aq sa është e mundur, luteni që ta njoftoni Gjykatën përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, të KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] dhe

(ii) Luteni që të na sqaroni se cila është praktika relevante gjyqësore përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSAK-ut, të vitit 1989 dhe dispozitave të Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës përmes Njoftimit të Punëdhënësit, si rezultat i konstatimit të shkeljeve të detyrave të punës nga punëmarrësit. Më konkretisht, luteni të na sqaroni se a ka Gjykata Supreme një praktikë gjyqësore të unifikuar në këso raste apo çështja e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, i KSAK nr. 12/89 apo Ligjit Themelor të Punës [Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27] shqyrtohet nga rasti në rast. Nëse Gjykata Supreme ka një praktikë të unifikuar dhe konsistente në lidhje me çështjet e sipërcekura, luteni që po ashtu të na sqaroni se nga cila periudhë saktësisht ka filluar unifikimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.

143. Gjykata Supreme ndaj pyetjeve të lartcekura ishte përgjigjur si në vijim:

“Fillimisht ju njoftojmë se në çështje të interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të dy Ligjeve të lartpërmendura në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës përmes njoftimit të punëdhënësit, si rezultat i konstatimit të shkeljeve të detyrave të punës nga punëmarrësit, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk ka një praktikë gjyqësore të unifikuar por interpretimi i këtyre dy Ligjeve, në rastet e lartpërmendura, bëhet për secilin rast të veçantë, thjeshtë nga rasti në rast. Megjithatë, duhet sqaruar se brenda për brenda kolegjeve të Gjykatës Supreme, në çështjet civile,

ekziston një konsensus si në vijim: Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës, i KSAK m. 12/89, dhe Ligji Themelor i Punës (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27) ka qenë në fuqi deri me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës më datë 17.12.2010 i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 90 më datë 1.12.2010, kur me nenin 99 par. 1 të këtij Ligji parashihet që „Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27), Ligji për Marrëdhënien i Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 (fjala është për këtë Ligj i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 12/89) dhe Ligji i Punës i Jugosllavisë i vitit 1977 me amandamentet përkatëse.

Nga kjo dispozitë rezulton se Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 ka qenë në fuqi dhe në zbatim deri me nxjerrjen e Ligjit të Ri mbi Punën të vitit 2010, mirëpo, ai në tërësinë e tij nuk ka pasur mundësi të zbatohet, kjo ngase me nenin 27 të Ligjit themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27) parashihet që kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të Ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të. Për faktin se me këtë Ligj Themelor të Punës të vitit 2001, nuk është paraparë fare procedurë disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës nga punëmarrësi, Gjykata Supreme ka konsideruar se konstatimi i këtyre shkeljeve të rënda, kryerja e tyre nga punëmarrësi, dhe përgjegjësia për kryerjen e tyre, duhet të vërtetohet në procedurë disiplinore të cilën e parasheh Ligji për Marrëdhënien e Punës i lartpërmendur, pasi që Ligji Themelor i Punës i vitit 2001, nuk parasheh fare procedurë disiplinore, as mënyrën e konstatimit të këtyre shkeljeve disiplinore, e as autoritetin e punëdhënësit i cili shqipton masa disiplinore për shkelje të ndryshme disiplinore. Tani me Ligjin e punës të vitit 2010 situatën e kemi plotësisht të qartë, nga se nuk parashihet fare procedura disiplinore, por punëdhënësve i cili mbetet që me aktet e tyre të brendshme të nxjerrin rregullore për procedurë disiplinore.”

144. Ashtu siç është cekur më lart, Gjykata megjithatë do të vazhdojë me shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij pretendimi duke marrë për bazë pesë (5) Aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës, të dorëzuara me kërkesën e tij në Gjykatë më 17 shtator 2020. Në kuptim të këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, të cilin pretendim parashtruesi i kërkesës e kishte mbështetur duke dorëzuar pesë (5) Aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, Gjykata do të vazhdojë me elaborimin e tri kritereve të lartcekura, duke filluar me elaborimin nëse ka dallime të thella dhe afatgjata.

(d) Vlerësimi i tri kritereve të përcaktuara në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

(i) Nëse ka dallime të thella dhe afatgjata

145. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta vetëm në raport me shkeljet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikën gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i

“dallimeve të thella dhe të afatgjata” në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të përkojnë me ato të rasteve kundërthënia me të cilat pretendohet.

146. Në kontekst të Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të referuara dhe dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës i ka dorëzuar vetëm kopjet e Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, por jo edhe vendimet të cilat i kane paraprirë këtyre të fundit apo ndonjë vendim tjetër.
147. Në vijim, Gjykata vëren se rrethanat e rasteve të lartcekura në pesë (5) Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të nxjerra në periudhën në mes të 20 nëntorit 2018 dhe 6 prillit 2020, ndërlidheshin me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga Ndërmarrja Publike KEK. Për pasojë, Gjykata vëren se në këto raste, Gjykata Supreme në parim kishte konstatuar se në rastet e të ish të punësuarve të kësaj ndërmarrje, ligji i zbatueshëm në lidhje me procedurën e shkëputjes së kontratës së punës ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Në vijim, Gjykata vëren se në dy (2) Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimeve [Rev. nr. 60/2020], të 6 prillit 2020; dhe [Rev. nr. 52/2019] të 11 marsit 2019, Gjykata Supreme ka konstatuar se nga Gjykata Themelore në mënyrë të gabuar është zbatuar e drejta materiale, si rezultat i aplikimit të Ligjit për Marrëdhënien e Punës, të vitit 1989. Ndërsa, në lidhje me tri (3) Aktgjykimet e tjera, gjegjësisht [Rev. nr. 1/2019] të 26 shkurtit 2019; [Rev. nr. 212/2019] të 11 korrikut 2019 dhe [Rev. nr. 377/2018] të 20 nëntorit 2018, Gjykata vëren se në këto aktgjykime nuk është përmendur se cili ligj ishte aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, gjegjësisht Gjykatës Themelore. Për më tepër, përkitazi me Aktgjykimin [Rev. nr. 377/2018] të 20 nëntorit 2018, Gjykatë vëren se kontrata e punëdhënësit ishte me afat të caktuar, dhe për pasojë Gjykata Supreme kishte vlerësuar se çështja e vazhdimit të kontratës së punës është në diskrecion të punëdhënësit.
148. Gjykata, duke iu rikthyer rastit të parashtruesit të kërkesës, rikujton Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme përkitazi me çështjen e interpretimit dhe aplikimit të ligjit në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim: *“Dispozitat e Ligjit mbi marrëdhënien e punës i KSAK nr.12/89 ishte i zbatueshëm sipas UNMIK/REG/1999/24 deri me aprovimin e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rreg. UNMIK2001/27, përveç atyre që janë në kundërshtim me këtë Rregullorë. Ky ligj ka qenë në fuqi deri në shfuqizimin e tij sipas nenit 27 të Rreg. UNMIK 2001/27 dhe me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212”*. Në vijim të këtij konstatimit të Gjykatës Supreme, ajo konstatoi si të drejtë qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se në bazë të dispozitave të Ligjit për Marrëdhënien e Punës nr. 12/89 të vitit 1989, Njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës, së 21 prillit 2008, ishte i paligjshëm.
149. Së dyti, Gjykata Supreme vlerësoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, nuk *“përmban elemente të parapara me ligj si udhëzimi apo këshilla juridike, nuk respekton kohën e paraparë për dëgjim të palës dhe shkëlja e pretenduar e punëtorit nuk i përgjigjet sanksionit disiplinor”*. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se Njoftimi, i 21 prillit 2008, është i paligjshëm dhe vërtetoi konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët, të cilat kishin konstatuar se kundër F.S. *“nuk ishte zhvilluar procedurë disiplinore për të vërtetuar përgjegjësinë e F.S. dhe nuk ishte shqiptuar masa adekuate me shkëljen e paraparë me aktin e brendshëm”*.

150. Gjykata në këtë aspekt rithekson qëndrimin që ajo vazhdimisht ka mbajtur përkitazi me faktin se aplikimi dhe interpretimi i ligjit është në juridiksionin e gjykatave të rregullta; dhe që roli i saj është vetëm të sigurohet se aplikimi dhe interpretimi i ligjit nga gjykatat e rregullta janë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastet e GJENDJ-së, *Brualla Gomes de la Torre kundër Francës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 31; *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 54; *Kuchoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; *Işyar kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 20 nëntorit 2008 paragrafi 48; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 49). Thënë këtë, Gjykata gjithashtu ka theksuar se përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, janë rastet e arbitraritetit të dukshëm (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50).
151. Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata rikujton që GJENDJ ka theksuar se kundërthëniet në praktikën gjyqësore janë pjesë përbërëse e secilit sistem gjyqësor dhe që divergjenca në praktikën gjyqësore mund të ketë edhe brenda të së njëjtës gjykatë. Një gjë e tillë, nuk është detyrues në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastet e GJEDNJ-së, *Santo Pinto kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51). Për më tepër, dhe siç është cekur më lart, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtje legjitime të besimit të publikut në gjykata nuk ofrojnë/garantojnë një të drejtë në praktikë gjyqësore konsistente. Për më tepër që zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Atanasovski kundër "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë"*, Aktgjykim i 14 janarit 2010, paragrafi 38; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 58). Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përjashtim edhe nga këto parime të përgjithshme, është arbitrariteti i dukshëm, dhe në kuptim të vlerësimit të mungesës së konsistencës gjyqësore, vlerësimi nëse ka “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën përkatëse gjyqësore dhe nëse ka një mekanizëm efektiv për të adresuar të njëjtat.
152. Gjykata gjithashtu vëren, se për dallim nga rasti në shqyrtim, Gjykata Supreme në pesë rastet e lartcekura të dorëzuara nga vetë parashtuesi i kërkesës dhe përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljeve të rënda ka aplikuar dispozitat e Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27] gjatë periudhës 2018 dhe 2020.
153. Në vijim, Gjykata duke u bazuar në pesë aktgjykimet e lartcekura të dorëzuara nga parashtuesi i kërkesës, po ashtu vëren se përveç kundërthënieve në interpretimin apo të aplikimit të Ligjit të Marrëdhënies së Punës nr. 12/89, të vitit 1989 dhe të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27] nga ana e Gjykatës Supreme kundërthënie përbën edhe çështja e procedurave të brendshme që i kanë paraprirë shkëputjes së kontratës, si në rastin konkret ai i auditimit të brendshëm.

154. Gjykata, duke iu referuar praktikës së vet gjyqësore, përkatësisht rasteve KI87/18 dhe KI35/18, rikujton se ajo kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 6 (gjashtë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se: (i) kishte “*dallime të thella dhe afatgjata*”; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih rastet e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe paragrafët 81 deri 85; dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111). Përkitazi me rastet e përmendura të Gjykatës, Gjykata thekson se në rastet KI35/18 dhe KI87/18, objekt i çështjes para gjykatave të rregullta në të gjitha rastet ishte vendosja e lartësisë së kamatëvonesës përkitazi me kërkesat e kompanive të sigurimeve private, të parashtruara në kuadër të së drejtës në subrogim.
155. Gjykata në këtë rast ka parasysh që pesë (5) Aktgjykimet e dorëzuara të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës në momentin e parashtrimit të kërkesës së tij, i pasqyrojnë vetëm ato Aktgjykime që parashtruesi i kërkesës ka pasur qasje në to dhe në dispozicion për të mbështetur pretendimin e tij përkitazi me mungesën e praktikës së unifikuar në Gjykatën Supreme. Në lidhje me këtë, Gjykata në kuadër të pyetjes së saj parashtruar Gjykatës Supreme nuk i ka kërkuar që të dorëzojë Aktgjykime të tjera të natyrës dhe të rrethanave të ngjashme si me ato të parashtruesit të kërkesës, por ka kërkuar që kjo gjykatë të sqarojë çështjen e interpretimit dhe aplikimit të këtyre dy ligjeve në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Dhe në lidhje me këtë përgjigje, Gjykata Supreme ka konfirmuar se shqyrtimi i rasteve që ndërlidhet me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të këtyre dy ligjeve zhvillohet nga rasti në rast.
156. Në vijim, Gjykata po ashtu vë në pah se në praktikën e saj gjyqësore ka shqyrtuar edhe raste që ndërlidheshin me çështjen e interpretimit të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27], apo të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës të KSAK. Në rastet e Gjykatës KI185/13, (me parashtrues *Korporata Energjetike e Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 shkurtit 2014) dhe KI186/13, (me parashtrues *Korporata Energjetike e Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2013) Gjykata Supreme në këto dy raste kishte aprovuar revizionin e punëmarrësve të KEK-ut duke anuluar vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, respektivisht dhe pasi kishte aplikuar dispozita e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, kishte konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit KEK për shkak të performancës së dobët, ishte i paligjshëm si rezultat i mungesës së zhvillimit të procedurës së Komisionit disiplinor brenda punëdhënësit. Në rastin e Gjykatës KI29/17 me parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, rrethanat e këtij rasti ndërlidheshin me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit KEK, si rezultat i konstatimit të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, gjegjësisht manipulimit të njehsorit dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, të cilat ishin konstatuar në raportin e auditimit të brendshëm. Si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit ishte anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme dhe duke iu referuar

edhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës, të KSAK pretendoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës si rezultat i mungesës së zhvillimit të procedurës disiplinore nga ana e punëdhënësit është në kundërshtimin me dispozitat e këtij ligji. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj [Rev.nr. 343/2016] kishte refuzuar revizionin e tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe kishte konstatuar se në rastin e tij ishte Ligji Themelor i Punës, ligj i aplikueshëm dhe se Njoftimi i punëdhënësit (KEK) për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte bërë në pajtim me nenin 11.2 të këtij ligji. Si rezultat i këtij vendimi të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kishte kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr.343/2016] duke theksuar se Gjykata Supreme, Aktgjykimin e të cilës po ashtu e kishte dorëzuar në Gjykatë në një rast tjetër në rrethana të njëjta juridike dhe faktike që po ashtu ndërlidheshin me një ish-punonjës të KEK-ut të cilit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i manipulimit të njehsorit dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 62/2014, të 20 marsit 2014] kishte aprovuar revizionin e ish-punonjësit të KEK-ut; kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe duke aplikuar dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, të KSAK, kishte konstatuar se Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljeve të rënda ishte i paligjshëm për arsye se punëdhënësi nuk kishte zhvilluar procedurë të Komisionit disiplinor.

157. Në lidhje me rastin e lartcekur, Gjykata duke aplikuar kriteret e lartcekura të GJEDNJ-së që ndërlidhen me divergjencën në praktikën gjyqësore të Gjykatave kishte vlerësuar: *“...se nuk është e mundur te konstatohet ekzistimi i dallimeve te thella dhe te vazhdueshme ne praktiken gjyqësore te Gjykatës Supreme qe rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktgjykim te Gjykatës Supreme, te nxjerre 3 (tri) vite me herët“* (paragrafi 53 i Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës).
158. Në vijim të këtij elaborimi, Gjykata vëren se çështja e kundërthënieve në interpretimin dhe aplikimin e Ligjit për Marrëdhënien e Punës, të vitit 1989 apo Ligjit Themelore të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27] nga gjykatat e rregullta, përfshirë edhe vet Gjykatën Supreme daton edhe më herët se periudha e nxjerrjes së vendimit të kontestuar. Për pasojë, Gjykata vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë edhe me dallime afatgjata në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme.
159. Tutje, Gjykata rikujton se çështja e vendimeve kundërthënëse, në kuptim vetëm të interpretimit Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut], gjegjësisht nenit 11, paragrafit 5 të tij ishte trajtuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih rastin KI89/13, parashtruese *Arbresha Januzi*, Aktgjykim, i 12 marsit 2014). Në këtë rast, megjithëse në rrethana faktike e juridike të ndryshme Gjykata kishte trajtuar çështjen e dy (2) vendimeve kundërthënëse në rrethana identike faktike dhe juridike brenda punëdhënësit të njëjtë, por në kuadër të parimit të mosdiskriminimit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës (shih paragrafët 63-70 të këtij Aktgjykimi). Megjithatë, edhe në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata kishte vënë në pah se brenda praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme në dy raste, përkatësisht Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses së kërkesës dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përkitazi me rastin e dy kolegeve brenda punëdhënësit të njëjtë, ekzistonin kundërthënie në

interpretimin e nenit 11 të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut] (paragrafët 56 -57 të Aktgjykimit në rastin KI89/13).

160. Nga sa më sipër, rezulton që Gjykata Supreme duke interpretuar dhe aplikuar dy ligje të ndryshme, përkatësisht Ligjin mbi Marrëdhënien e Punës të KSAK, nr. 12/89 dhe Ligjin Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27] në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike në rastin e ndërprerjes apo shkëputjes së marrëdhënies së punës për shkak të shkeljeve të detyrave, nga ana e punëdhënësit ka rezultuar në interpretim dhe praktikë kundërthënëse, dhe si rezultat i kësaj në praktikën e saj gjyqësore ekzistojnë *dallime të thella dhe afatgjata* (shih, në këtë rast, rastin e GJEDNJ-së *Iordan dhe Iordanov kundër Bullgarisë*, të cituar më lart, paragrafët 49-50).
161. Në këtë kontekst dhe për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë se në rrethanat e rastit konkret, dhe përkitazi më interpretimin dhe aplikimin e Ligjit për Marrëdhënien e Punës nr. 12/89 dhe të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut 2001/27] ekzistojnë “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta.
162. Në anën tjetër, konstatimi se ka “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesave, nuk rezulton detyrimisht në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për të konstatuar një gjë të tillë, Gjykata duhet të shqyrtojë edhe dy kriteret e tjera të GJEDNJ-së që ndërlidhen me vlerësimin e mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore, përkatësisht nëse ligji i aplikueshëm përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe nëse një mekanizëm i tillë është zbatuar në rrethanat e një rasti dhe me çfarë efekti.
- (ii) *Nëse ligji i aplikueshëm përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe*
- (iii) *nëse një mekanizëm i tillë është zbatuar në rrethanat e një rasti dhe me çfarë efekti.*
163. Gjykata thekson se Gjykata Supreme ka një mekanizëm që mundëson zgjidhjen e kundërthënieve të tilla. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në rastin KI87/18, Gjykata kishte theksuar se bazuar në pikën 10 të paragrafit 2 të nenit 14 (Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës) të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatat), Kryetarët e gjykatave përmes takimeve vjetore të të gjithë gjyqtarëve kanë detyrimin, ndër të tjera, për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika (shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 80). Përmes këtij rasti, Gjykata gjithashtu theksoi se funksionimi i vetë mekanizmit të harmonizimit të praktikës nuk është i pamundësuar, apo i kufizuar me asgjë, gjë që do të zvogëlonte drejtpërdrejt zbatimin dhe efikasitetin e tij në vetë praktikën gjyqësore (shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtues “*IF Skadeforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 81).
164. Megjithatë dhe për më tepër, Gjykata përmes rastit KI87/18 gjithashtu ka theksuar se pika 4 e paragrafit 1 të nenit 26 (Kompetencat e Gjykatës Supreme) të Ligjit për Gjykatat, përcakton kompetencën ekskluzive të vet Gjykatës

Supreme për të përcaktuar qëndrimet parimore, nxjerrë mendime juridike dhe udhëzuese për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës. Në çështjen që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, përkatësisht çështjen e interpretimit të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, të KSAK-ut nr. 12/89, apo dispozitave të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27], Gjykata Supreme, përmes përgjigjes së saj të dorëzuar më 10 tetor 2021 në Gjykatë, deklaroi se nuk kishte një praktikë të unifikuar në këto raste. Më konkretisht, Gjykata Supreme konfirmoi se çështja e zbatimit të këtyre dy ligjeve të lartcekura shqyrtohet nga rasti në rast.

165. Në kuptim të kësaj, Gjykata konsideron që Gjykata Supreme si rezultat i mungesës së një praktike të unifikuar në këso lloj rastesh ka shërbyer vet si burim i divergjencave në praktikën gjyqësore, duke cenuar kështu parimin e sigurisë juridike.
166. Gjykata thekson se GJEDNJ vazhdimisht ka theksuar se roli i një gjykate supreme është pikërisht për të zgjidhur kundërthënie të tilla. Për më tepër, ajo gjithashtu ka mbajtur se, nëse praktika kundërthënëse zhvillohet brenda një prej autoriteteve më të larta gjyqësore në një vend, vetë ajo gjykatë bëhet burim i pasigurisë juridike, duke minuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe duke e dobësuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor (shih në këtë rast rastin e GJEDNJ-së *Famullia Greko-katolike Lupeni kundër Rumanisë*, të cituar më lart, paragrafi 123, *Beian kundër Rumanisë*, të cituar më lart, paragrafi 39 dhe *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, të cituar më lart, paragrafi 38).

(e) Konkludim

167. Rrjedhimisht, Gjykata duke marrë parasysh të lartcekurat, konstaton se në rrethanat e rastit konkret, plotësohen të tri kriteret e GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjencat në praktikën gjyqësore, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, konstaton:
 - (i) “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me interpretimin dhe aplikimin e Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës së KSAK dhe të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut 2001/27];
 - (ii) se ekzistojnë mekanizmat të Gjykatës Supreme për harmonizimin e kësaj praktikë, dhe se
 - (iii) ky mekanizëm ekzistues, ashtu siç është deklaruar edhe nga vet Gjykata Supreme nuk është përdorur.
168. Si rezultat, Gjykata duhet të konstatojë se në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, “*dallimet e thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të ndërlidhura me mospërdorimin e mekanizmave të përcaktuar me ligj e të dizajnuar për të siguruar konsistencën e duhur brenda praktikës gjyqësore të gjykatës më të lartë në vend, kanë rezultuar në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

169. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vë në pah se konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me mospërdorimin e mekanizmit nga ana e Gjykatës Supreme, mekanizëm ky i përcaktuar me ligj e i dizajnuar për të siguruar konsistencën e duhur brenda praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit apo qëndrimin juridik që Gjykata Supreme e vendos dhe e aplikon në rastin konkret.
170. Prandaj, Gjykata Supreme në procedurë të rivendosjes, pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të parashtruara në revizionin e tij në Gjykatën Supreme, e që ndërlidhen me ligjshmërinë e Njoftimit të tij për shpërbërje të marrëdhënies së punës duhet t'i shqyrtojë dhe vlerësojë në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi, dhe varësisht nga qëndrimi apo rezultati i mekanizmit të përdorur nga Gjykata Supreme që ndërlidhen me çështjen e divergjenës së praktikës gjyqësore të kësaj gjykate përkitazi me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës së KSAK, nr. 12/89 dhe atyre të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut 2001/27], të njëjtat t'i aplikojë në rastin e parashtruesit të kërkesës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe nenit 24 të Kushtetutës

171. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe nenit 24 të Kushtetutës, dhe pretendimin e tij në lidhje me këtë të fundit e ndërlidhë me aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të dorëzuara në Gjykatë, në të cilat raste punëdhënës ishte Ndërmarrja Publike KEK. Në vijim të kësaj, Gjykata ka konstatuar se në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, "*dallimet e thella dhe afatgjata*" në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të ndërlidhura me mospërdorimin e mekanizmave të përcaktuar me ligj e të dizajnuar për të siguruar konsistencën e duhur brenda praktikës gjyqësore të gjykatës më të lartë në vend, kanë rezultuar në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejte dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, në mënyrë të ngjashme, rastin *Iordan Iordanov kundër Bullgarisë*, të cituar më lart, paragrafi 54). Rrjedhimisht, si rezultat i këtij konstatimi Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe nenit 24 të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ac.nr.1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit

172. Gjykata rikujton se më 7 mars 2022, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë ka parashtruar kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit [Ac.nr.1578/2021] të 10 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë në procedurë kontestimore.

173. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në pah se procedura e zhvilluar kontestimore që i ka paraprirë nxjerrjes së Aktgjykimit [Ac.nr.1578/2021] të 10 janarit 2022, i referohet pikës së parë të dispozitivit të Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës kjo e fundit kishte vendosur që:

“Pranohet, si pjesërisht i bazuar revizioni i të paditurës “Raiffeisen Bank” [parashtruesi i kërkesës], dhe Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [...] dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C. Nr. 593/2014 datë 21 shtator 2015 në pjesën III të dispozitivit që ka të bëjë me detyrimin e [parashtruesit të kërkesës] që paditësin ta kthejë në pozitën që ka qenë duke punuar, si zëvendës të menaxherit të bankës Raiffeisen Banka-Dega në Prizren dhe për këtë pjesë, çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.”

174. Gjykata vë në pah se pika e parë e dispozitivit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nuk është objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, pasi që parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij të dorëzuara më 17 shtator 2020 në Gjykatë kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së pikës së dytë të Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës kjo e fundit kishte vendosur që të refuzojë si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me anulimin si të kundërligjshëm të Njoftimit të 21 prillit 2008 për shpëputjen e marrëdhënies së punës së F.S..
175. Bazuar në si ma lart, Gjykata vlerëson se kërkesa për masë të përkohshme e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës më 7 mars 2022 ndërlidhet me procedurën e cila nuk përbën çështje të vlerësimit të kërkesës dhe e njëjta duhet të refuzohet.

Përfundime

176. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së përkitazi me mosarsyetim të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike në aspektin e konsistencës së praktikës gjyqësore, garanci këto, që me përjashtime të caktuara, janë të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
177. Së pari, sa i përket pretendimit përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e që ndërlidhet me parimin e sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës, përkatësisht divergjencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, Gjykata, pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të GJEDNJ-së në këtë aspekt, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, dhe konstatoi se si rezultat i mungesës së një mekanizmi të vendosur nga kjo gjykatë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme ka *“dallime të thella dhe afatgjata”* përkitazi me ligjin e aplikueshëm në rastet e shpëputjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, dhe rrjedhimisht konstatoi se përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 12/2020] të 19 shkurtit 2020 ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme. Në këtë linjë, Gjykata theksoi se Gjykata Supreme në procedurë të rivendosjes, pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të parashtruara në revizionin e tij në Gjykatën Supreme, e që ndërlidhen me ligjshmërinë e Njoftimit të tij për

shkëputje të marrëdhënies së punës duhet t'i shqyrtojë dhe vlerësojë në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi, dhe varësisht nga qëndrimi apo rezultati i mekanizmit të përdorur nga Gjykata Supreme që ndërlidhen me çështjen e divergjenës së praktikës gjyqësore të kësaj gjykate përkitazi me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës së KSAK, nr. 12/89 të vitit 1989 dhe atyre të Ligjit Themelor të Punës [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27], të njëjtat t'i aplikojë në rastin e parashtruesit të kërkesës.

178. Së dyti, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe nenit 24 të Kushtetutës, si rezultat i trajtimit të pabarabartë, Gjykata, si rezultat i konstatimit të saj për shkelje të së drejtës për siguri juridike të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i praktikës kundërtshënëse gjyqësore të Gjykatës Supreme, nuk e vlerësoi si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor dhe nenit 24 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 57 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 mars 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se pika II e dispozitivit të Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshme pikën II të Aktgjykimit [Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin [Rev.nr.12/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- VI. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 30 shtator 2022, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani